



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë
Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Departamenti për Patentë Shoferë dhe Automjete
Odeljenje za vozačke dozvole i vozila Department for
Driver's License and Vehicles*

Grup autorësh

**DORACAK PËR DHËNIEN E PROVIMIT PROFESIONAL PËR
INSTRUKTOR SHOFERË**

*Doracak i autorizuar nga Ministria
2025*

DORACAK PËR DHËNIEN E PROVIMIT PROFESIONAL PËR INSTRUKTOR SHOFERË

Autorë:

**Habib Hasani, Xhevat Gashi, Avni Abdyli, Vlora Hasanramaj,
Reshat Sylejmani, Burim Deliu, Mirditë Emini**

Recensentë:

**Fejzulla Mustafa
Shkumbim Leka**

Bashkëpunëtorë profesional

**Ruzhdi Matoshi
Ekrem Latifi**

**Lektorimi:
Merlinda Spahiu**

**Fotografitë:
Autorët**

**Burime nga interneti
Burimet tjera**

Prishtinë 2025

Ndalohet botimi, fotokopjimi apo shfrytëzimi i këtij doracaku për përfitime materiale edhe në mënyrë fizike apo/dhe elektronike.

Ky doracak nuk lejohet në asnjë mënyrë të shitet as për t'i mbuluar shpenzimet e shtypjes apo përdorimit elektronik.

Moszbatimi i kushteve të sipërshtuara përbënë vepër penale të marrjes së autorësisë për përfitime materiale.

Përmbajtja

1. HYRJE NË PROFESIONIN E INSTRUKTOR SHOFERIT.....	6
2. VEPRIMET FILLESTARE TË AFTËSIMIT.....	15
3.AFTËSIMI I KANDIDATIT NË POLIGON.....	25
4.AFTËSIMI BRENDA DHE JASHTË VENDBANIMIT.....	33
5. LITERATURA.....	117

Parathënie

Ky doracak u hartua nga grupi punues i autorizuar nga Ministria bazuar në ***planprogramin për dhënie e provimit profesional për instruktor shoferë***.

Kandidat për dhënie e provimit profesional për licencim të instruktorë i dedikohen të gjithë kapitujt e këtij doracakut, ndërsa për përtrirje të licencës instruktori e përgatit dhënie e provimit vetëm materialin nga kapitulli i katërt (4).

Doracaku në fjalë ka për qëllim që kandidati për instruktor shofer të njihet dhe të kuptojë domethënie e e profesionit për instruktor shoferë si dhe mënyren e aftësimit të kandidatëve për shoferë. Duke pasur parasysh se instruktori bënë aftësimin e kandidatëve vetëm nga pjesa praktike, ashtu që ne si grup punues e kemi parë të arsyeshëm më së shumti të fokusohem në këtë pjesë.

Disa nga fotografit (ilustrimeve) të përdorura në këtë doracak janë të njëjta me ato që përdoren në në pyetjet publike të kandidatëve për shoferë të kategorisë B.

Ne si grup punues jemi të vetëdijshëm se gjatë hartimit të këtij doracakut mund të ketë ardhur deri te ndonjë lëshim qoftë teknik apo i natyrës tjetër, prandaj ju lutemi përdoruesve të doracakut në fjalë që të mos ngurrojnë dhe të na shkruajnë për çfarëdo lëshimi eventual, rekomandim apo sugjerim me qëllim mirë. Ndërsa ne do t'ju jemi mirënjohës e falenderuës dhe njëkohësisht do t'i marrim parasysh ato, në mënyrë që botimi tjetër i radhës të jetë edhe më cilësorë dhe më praktik se ky i tanishmi.

Autorët

KAPITULLI I - I

HYRJE NË PROFESIONIN E INSTRUKTOR SHOFERIT

1. HYRJE NË PROFESIONIN E INSTRUKTOR SHOFERIT

Nacionet

Nacionet që përdoren në këtë hyrje të profesionit të instruktor shoferit janë:

“Autoshkollë” - subjekti që bënë aftësimin (trajnimin) e kandidatëve për shofer të automjeteve;

“Kandidat për shofer” - personi i cili është regjistruar në autoshkollë për aftësim për shofer;

“Instruktor i shoferëve” - person i autorizuar për aftësim të kandidatëve për shoferë nga pjesa praktike për kategorinë përkatëse;

“Licencë e instruktorit të shoferëve” - dokumenti publik të cilën e lëshon Ministria përkatëse për Transport që dëshmon të drejtën për të aftësuar kandidatin për shofer nga pjesa praktike.

Procedurat për licencimin e instruktor shoferit

Provimit profesional për licencim të instruktorit shoferit mund ti nënshtrohet kandidati i cili e ka të përfunduar trajnimin bazë për instruktor shoferë.

Provimi profesional për lincencim organizohet nga pjesa teorike dhe praktike, ndërsa për përtrirje të licencës vetëm nga pjesa teorike.

Provimi profesional nga pjesa praktike për licencimin e instruktor shoferit jepet vetëm në rrugë publike. Kandidati i cili paraprakisht ka treguar rezultat pozitiv në provimin teorik ka të drejtë ti nënshtrohet provimit praktik.

Pjesa praktike e provimit profesional ndahet në dy pjesë:

a) Pjesa e parë e provimit përfshinë ngasjen personale:

- Kontrollin e automjetit (kontrollin teknik ditor preventiv: verifikimi i nivelit të vajit në motor, lëngun për ftohje, lëngun për larje të xhamit, pajijset, pneumatikët, përshtat ulsën, merr pozitën e drejtë, përshtat pasqyrat e shoferit, vendos rripin e sigurisë dhe mbsështetësin e kokës nëse është në dispozicion);
 - Sjelljen në trafik;
 - Teknikën e ngasjes;
 - Vëzhgimin dhe përcjejen sistuatës në trafik, marrëdhëniet e pjesëmarrësve tjerë në trafik;
 - Kryerja e veprimeve me kohë dhe në mënyrë të drejtë;
 - Aplikimin e ngasjes defanzive (ngasjen e përshtatshme, parashikimi, vendimmarrja në situatat reale në trafik);
- Aplikimin e Eko-ngasjes dhe ngasjen e sigurtë

a) Pjesa e dytë e provimit përfshinë “Udhëheqjen dhe vlerësimin e kandidatit (kandidati e luan rolin e instruktor shoferit).”

Kandidati për instruktor shoferë në pjesën e provimit “udhëhqja e kandidatit në rrugë” duhet:

- Të ketë aftësi komunikuese;
- Të vlerësoj sjelljen dhe tekniken e ngasjes;
- Të vlerësoj mënyrën e sjelljes dhe reagimin e kandidatit në situat konkrete në trafik;
- Të reagoj në mënyrë verbale dhe fizike në situat e rrezikshme në trafik;
- Që pas përfundimit të ngasjes, kandidati për instruktor shoferë t'ia komunikoj gabimet që kandidati për patentë shoferë i ka bërë gjatë ngasjes (raporti i ngasjes);
- Të bëjë vlerësimin përfundimtar të kandidatit për patentë shoferë sipas kriterëve të vlerësimeve të gabimeve dhe tregon se kandidati “është aftësuar” apo “nuk është aftësuar”.

Komisioni e vlerëson kandidatit për instruktor shoferë, në bazë të teknikës së ngasjes, udhëheqjes së kandidatit, komunikimit të gabimeve dhe vlerësimit përfundimtar në provim.

Gabimet vlerësohen si gabim i vogël, serioz, dhe i rrezikshëm. Kandidati i cili vlerësohet me një gabim serioz apo të rrezikshëm nuk kalon në provim.

Kandidati i cili vlerësohet me katër (4) gabime të vogëla ose i përsëritë dy (2) herë të njëjtin gabim të vogël nuk kalon në provimin profesional për instruktor shoferë.

Kohëzgjatja e provimit praktikë në rrugë publike është së paku tridhjetë (30) minuta deri 45 minuta.

Kandidati i cili me suksese kalon pjesën e provimit “ngasja personale” vazhdon pjesën e dytë të provimit. Udhëheqja e kandidatit në rrugë /publike (rolin e instruktor shoferit). Njëri prej anëtarëve të komisionit e luan rolin e kandidatit për patentë shoferë.

Aftësimin praktik e realizon instruktori i shoferëve i cili ka licencë të vlefshme dhe i plotëson kushtet e paraparë.

Minimumi i orëve mësimore nga pjesa praktike e aftësimit të kandidatit për kategorinë B janë së paku njëzet (20) orë, ndërsa për kategoritë e tjera së paku pesëmbëdhjetë (15) orë.

Të drejtat dhe obligimet e instruktorit të shoferëve

Instruktori i shoferëve brenda ditës ka të drejtë të punojë më së shumti tetë (8) orë nga pjesa praktike duke llogaritur edhe orët praktike të kandidatëve për kategoritë e ndryshme.

Instruktori i shoferëve gjatë orës praktike obligohet që:

- me kohë dhe në mënyrë të rregullt të plotësojë urdhëresën e punës;
- me kohë dhe në mënyrë të rregullt të plotësojë kartelën e kandidatit;
- të ketë planprogramin e aftësimit të kandidatëve;
- të ketë patentë shoferin;
- të ketë certifikatë shëndetësore të vlefshme;
- të ketë licencë për instruktor të shoferëve.

Instruktori i shoferëve i cili është duke e bërë aftësimin e kandidatit për shofer nga pjesa praktike, me kërkesë të personit zyrtar të Ministrisë (Inspektorëve) është i obliguar të ndalet dhe të ofrojë dokumentacionin e kërkuar.

Personi zyrtar i Ministrisë me rastin e ndaljes së automjetit të autoshollës duhet të sinjalizojë për ndalje me shenjën “STOP INSPEKTORI”.

Aftësimi nga pjesa praktike realizohet me automjet për secilën kategori veçmas.

Automjeti për aftësimin e kandidatëve për shoferë, duhet t'i plotësojë kushtet shtesë si në vijim:

- duhet të jetë i regjistruar, me kontrollim periodik gjashtëmujor (6), me komanda shtesë të atestuara;
- të jetë i shënjuar për secilën kategori me shkronjën “L”;
- t'i plotësojë kushtet teknike për pjesëmarrje të sigurt në trafik;
- t'i plotësojë kushtet higjienike.

Instruktori i shoferëve ka për detyrë të verifikojë që kandidati për shoferë para fillimit të orës praktike i ka dokumentet si vijon:

- kartelën e kandidatit;
- certifikatën mjekësore të vlefshme.

Para çdo ngasje, kandidati për shofer dhe shofer-instruktori duhet të jenë fizikisht dhe psikikisht të aftë për ngasje.

Kushtet që kandidati duhet ti plotësoj janë dhënë në vijim:

- nuk është në stresë,
- nuk është i sëmurë,
- të mos jetë në ndikim të alkoolit, drogës apo të barnave të cilat nuk lejohen të përdoren para dhe gjatë ngasjes,
- se është mjaftueshëm i pushuar për aftësim,
- se rendit dhe përserit sipas nevojës temen që ka trajtuar,
- se vërtet dëshiron dhe i pëlqen ngasja gjatë aftësimit,
- të përqendrohet mjaftueshëm për të qenë në gjendje të ndjekë në mënyrë aktive instruksionet e shofer instruktorit,
- të jetë i veshur siç duhet (modest).

Shofer Instruktori gjatë aftësimit pritët të:

- Të zbatoj parime të njëjsive mësimore gjatë aftësimit, përkatësisht:
- Parimi i qartësisë ose shembullit,
- Parimi i lidhshmërisë së teorisë dhe praktikës,
- Parimi i aktivitetit të ndërgjegjshëm (inkurajoni kandidatët të marrin pjesë aktive në aftësim),
- Parimi i sistematizmit ose gradualizmit, (nga veprimet më të thjeshta në më komplekse),
- Parimi i racionalizimit ose ekonomisë (për t'u përgatitur për orë),

-Parimi i individualizimit (përshtatja me veçoritë e kandidatit),

-Parimi i qëndrueshmërisë (verifikimi).

Përveç parimeve të sipërshënuar, shoferi- instruktori duhet të përdorë edhe sa vijon metodat e aftësimit dhe zakonisht duhet të përdoren një kombinim i metodave të mëposhtme:

-Metoda e prezantimit me gojë – kjo metodë duhet praktikuar sa më pak, është e pashmangshme, por ka një veçori të keqe që instruktori nuk ka reagime nga kandidati,

-Metoda e tregimit ose demonstrimit - fillimisht instruktori dhe më pas kandidati,

-Metoda e bashkëbisedimit - metoda e pyetjeve dhe përgjigjeve (njësitë problematike)

-Metoda e aftësimit.

Vetëm nëse plotësohen kushtet e sipër shënuar, mund të priten rezultate pozitive nga aftësimi, gjë që mundëson në një përvetësim më të mirë dhe më të shpejtë të njëjësive mësimore, që rezulton siguri më e madhe për pjesëmarrësit në trafik.

Gjatë aftësimit nga pjesa praktike, në automjetin e autoshollës merr pjesë vetëm instruktori i shoferëve dhe kandidati i cili aftësohet për kategorinë përkatëse.

Planifikimi i orës mësimore

-lënda mësimore;

-materiali mësimore,

-ora mësimore

- njësia mësimore.

Elementet e planifikimit të aftësimit

Në vijim është dhënë si duhet planifikuar dhe organizuar aftësimi nga pjesa praktike

Shifra	Përmbajtja e aftësimit në rrugë publike-sjellja në trafik	Ora mësimore	Vendi i aftësimit
T9	Hyrja në autostradë ose në rrugë të ngjajshme	Hyrja në autostradë dhe dalja nga to, (hyrja në trafik në shiritin për rrxitim, dalja nga rrjedhja e trafikut nga shiriti për ngadalësim)	Brenda dhe jashtë vendbanimit

Objektivat: pas përfundimit të orës mësimoreqë kandidati të jetë në gjendje që në mënyrë të sigurt të ngas automjetin në autostradë si dhe me rastin e hyrjes duke shfrytëzuar shiritin për nxitim dhe për dalje duke shiritin përngadalësim.

Përmbatja e orës mësimore që kandidati duhet të mësojë

- Përmbatja e planit

Përmbatja e orës mësimore që kandidati duhet të mësojë.

Lajmrimi i shenjës-autostrada

- Njohja e shenjës së trafikut.

Hyrja në autostradë pa shirit të nxitimit

- Para hyrjes në autostradë të shikohet mundësia pa u ndalur te shenja e trafikut,
- Sinjalizimi me tregues të drejtimit,
- Vlerësimi i largësisë dhe shpejtësisë së lëvizjës së automjeteve që lëvizin nëpër autostradë,
- Jepja e përparësisë së kalimit të gjithave automjeteve të cilat lëvizin nëpër autostradë,
- Hyrja në autostradë duke mos i penguar dhe i rrezikuar automjetet që lëvizin në autostradë.

Shfrytëzimi i shiritit për nxitim nëse ekziston

- Hyrja në autostradë duke shfrytëzuar shiritin për nxitim dhe sinjalizimi me tregues të drejtimit,
- Rritja e shpejtësisë sipas nevojës dhe hyrja në autostradë në fund të shiritit për nxitim,
- Vlerësimi i largësisë dhe shpejtësisë së lëvizjës së automjeteve që lëvizin nëpër autostradë.

Ngasja në autostradë

- Ngasja e automjetit të kandidatit nëpër autostradë, në shiritin e djathtë të skajshëm nëse nuk është i zënë në kolon,
- Shfrytëzimi i shiritit të majtë për tejkalim,
- Ndërrimi i shiritave duke vështuar trafikun nga prapa(pasyre e brendshme, jashtme,këndi vdekur dhe sinjalizimi me tregues të drejtimit),
- Mos lëvizja në distancë të vogël ndaj automjetit që lëvizin përpara.

Sjella në rast defektive autostradë

- Ndalja në shiritin për ndalje emergjent,
- Vendosja e trekëndshit të sigurisë në distancë prej së paku 100 metra,
- Ndezja e të gjithë treguesve të drejtimit.

Shfrytëzimi i shiritit për nxitim ngadalësim

- Dalja nga autostradë duke shfrytëzuar shiritin për ngadalësim dhe sinjalizimi me tregues të drejtimit,
- Zvogëlimi i shpejtësisë sipas nevojës vetëm pasi kalon në shiritin e ngadalësimi në fillim të këtij shiriti .

Vlerësimi i largësisë dhe shpejtësisë së lëvizjës së automjeteve që lëvizin nëpër autostradë.

Tipi i orës mësimore

- përgatitja e orës vijuese,*
- ushtrimet,*
- përseritja,*
- kombinimi i orës mësimore.*

Detyrat për realizimin

Edukimi (përvetësimi i vlerave edukative)

Njohurit (arritja e njohurive dhe shkathtësive)

Funksionimi (zhvillimi i aftësimit)

Edukimi përfshinë:

- Përvetësimi i vlerave edukative,*
- Zhvillimi i vetëdijes për rrezikun në autostradë*
- Ndërtimi i qëndrimeve pozitive për sjellje të drejtë autostradë, hyrja, ngasja dhe dalja nga autostrada dhe të përvetësojë ndjenjën e përgjegjësisë personale...*

Njohurit

Arritja e përmbatjes së njohurive:

Të mësohen rregullat e trafikut dhe sigurisë dhe sinjalizimit rrugor si dhe sjellja gjatë hyrjes, ngasjes dhe daljes nga autostrada.

Funksionimi (zhvillimi i aftësimit)

Zhvillimi shkathtësive, përcjellja, parashikim, njohja e rrezikut në autostradë si dhe mënyra e shmangjes së rrezikut..

Vendi i aftësimit

- Ku ekzistojnë elementet teknike të trafikut,*
- Ku kandidati ka mundësi të aftësohet në situatat e ndryshme të trafikut;*
- Ekonomizimi,*
- Vendet e përshtatshme për realizimin e orës mësimore.*

Metodat e aftësimit

- **Forma frontale**- e cila nënkupton punën e instruktorit në të njejtën kohë me grupin sa më të madhë të kandidatëve,
- **Forma grupore**- që nënkupton punën e instruktorit me numrin e caktuar të kandidatëve,
- **Puna në çifte apo tandem**- që nënkupton punën e dy instruktorëve me një kandidatë.
- **Forma individuale** – që nënkupton punën e një instrukturi vetëm me një kandidat.

Tek ne përdoret metoda individuale që nënkupton gjatë aftësimit praktik është instruktori vetëm me një kandidat për shoferë.

Metodat mësimore

Instruktor shoferi i përdor metodat e:

- sqarimit
- tregimit
- bisedimit
- ushtrimeve (e saktë, drejtë, e sigurt dhe shpejtë).

Mjetet mësimore dhe pajisjet ndihmëse

- Automjeti me pajisje përkatës sipas kategorive,
- Doracaku,
- Blloku për skicimi apo të ngjajshme,
- Konat varisht nga kategorija.

Artikulimi i orës mësimore

- pjesa hyrëse- objektivat
- pjesa kryesore-ushtrimet (veprimet me automjet, shprehjet e sigurtë, gabimet eventuale)
- pjesa përfundimtare.

Pjesa hyrëse e orës mësimore përfshinë:

- kontrollimi teknik preventiv ditor i automjetit
- përgatitja për ngasje,
- përseritjet,
- objektivat e orës mësimore.

Pjesa kryesore - ushtrimet përfshinë:

Hyrja, ngasja dhe dalja nga autostrad siç është përshkruar nga lartë.

Pjesa përfundimtare

Perceptimi, analiza dhe korigjimi i gabimeve:

- shkaku i gabimeve,
- pasojat e mundshme për shkak gabimeve,
- mënyra e përmersimit të gabimeve,
- të tjera.

Faktorët e kohës – vonesa në ndërmarrjen e veprimeve, apo vrepimet e parakoshme. .

Faktorët kualitativ- veprimi jo i sakt, rradhitja e veprimeve në mënyrë të gabuar.

Faktorët kvantitativ-veprimet e lëshuar, veprimet e tepruara.

Etika e instruktorit dhe kandidatit

Instruktori dhe kandidati për shoferë duhet të jenë të veshur me veshje të përshtatshme që nuk janë provokuese dhe që nuk përmbajnë imazhe, mbishkrime dhe simbole që cenojnë moralin publik ose mund të jenë ofenduese për individët ose grupet.

Te gjinija femërore funet, pantallonat e shkurtra nuk mund të jenë më të shkurtra se gjuri.

Te meshkujt, nuk lejohen veshja e shorceve dhe pantollonat e shkurtër mbi gjunj.

Instruktori duhet të sillet mir ndaj kandidatit dhe të motivoj për orërt mësimore nga pjesa praktike dhe ti tratoj të gjithë njëjet pavarësisht statusit social, përkatësisë etnike, racore, fetare, etj.

Kontrollimi i dokumentacion për aftësim

Para fillimit të orës mësimore instruktori duhet të:

- Kontrollon letërnjoftimin e kandidatit dhe identitetin e tij;
- Kontrollon certifikatën mjekësore;
- Plotësoj kartelën e kandidatit dhe urdhëresën e punës;
- Vlerësoj gjendjen psikike dhe fizike të kandidatit;
- Motivoj kandidatin për orë mësimore dhe raportet e ndërsjella;
- Testoj të pamurit e kandidatit;
- Ndërmerr veprimin e duhur pas vlerësimit.

KAPITULLI I II

VEPRIMET FILLESTARE TË AFTËSIMIT

2.VEPRIMET FILLESTARE TË AFTËSIMIT


Veprimet fillesatre para nisjes së automjetit

Aftësimi (trajnimi) nga pjesa praktike realizohet sipas Udhëzimit Administrativ për Plan Programin e Aftësimit të Kandidatëve për Shofer.

Kandidati për shoferë duhet të ketë njohuri për automjetin me të cilin bëhet aftësimi për kategoritë përkatëse.

Në vijim është paraqitur tabela me pajisjet kryesore dhe funksionimin e tyre.

Tabela kontrolluese (komanduese) në automjet mundëson përcjelljen e punës së motorit. Ajo tregon kilometrat e kaluar dhe shpejtësinë e lëvizjes.	
Llamba kontrolluese sinjalizon (tregon) problemin me motor.	
Pajisja për ftohje (lëngu/uji) mundëson punën e motorit	
Shtypja e ulët të ajrit në pneumatik (goma) zvogëlon stabilitetin e mjetit dhe dëmton pneumatikët, rrit shpenzimet e karburantit.	
Timoni shërben për drejtimin e automjetit në kahun e dëshirueshëm.	
Sistemi ABS në automjet mundëson që në rast të frenimit të mos vijë deri te bllokimi i rrotave.	

<i>Pedalja e friksionit të cilën duhet shtypur para aktivizimit të motorit mundëson nisjen ngavendi dhe ndërrimin e shpejtësive.</i>	
<i>Llamba kontrolluese në foto sinjalizon (tregon) se temperatura e motorit e ka kaluar kufirin e lejuar – defekt në sistem të ftohjes.</i>	
<i>Llamba kontrolluese në foto sinjalizon (tregon) sasinë e pamjaftueshme të vajit në motor apo defektin në sistemin e lubrifikimit.</i>	
<i>Llamba kontrolluese në foto sinjalizon (tregon) se në automjet janë të ndezura dritat e shkurta.</i>	
<i>Llamba kontrolluese në foto sinjalizon (tregon) se në automjet janë të ndezura dritat e gjata.</i>	
<i>Llamba kontrolluese sinjalizon (tregon) dritat për mjegull</i>	
<i>Treguesit e drejtimit përdoren gjatë veprimeve me automjet (tejkalimi, kthimi majtas ose djthtas, etj).</i>	
<i>Llampa kontrolluese në foto sinjalizon (tregon) në automjet janë të ndezura të gjithë treguesit.</i>	
<i>Llamba kontrolluese sinjalizon (tregon) se alternatori nuk është duke funksionuar si duhet.</i>	

Llamba kontrolluese sinjalizon (tregon) se tempomati është i aktivizuar	
Llamba kontrolluese sinjalizon (tregon) se freni i parkimit është jashtë funksionit.	
Llamba kontrolluese sinjalizon (tregon) se rripi i sigurisë nuk është vendosur.	
Llamba kontrolluese sinjalizon (tregon) se ESP / Programi Elektronik i Stabilitetit është jashtë funksionit	
Llamba kontrolluese sinjalizon (tregon) sasinë e karubrantit	
Llamba kontrolluese sinjalizon (tregon) probleme me jastëk të ajrit.	
Llamba kontrolluese sinjalizon (tregon) se nxehtësit janë jashtë funksionit (Dizel).	
Llamba kontrolluese sinjalizon (tregon) se servo timoni nuk është në rregull.	
Regjimi EKOLOGJIK	

Distanca e sigurisë e vogël.	
Numri i rrotullimeve të motorit.	
Numëri i rrotullimeve të motorit në fushën e kuqe.	

Kandidati njoftohet për funksionimin e automjetit me theks të veçantë të pajisjeve të cilat ndikojnë drejtëpërdrejtë në sigurinë rrugore, pastaj motori, pajisjet e transmisionit, pajisjet sinjalizuese dhe ndriquese, tabelën instrumentale, pajisjet teknologjike (inteligjente) funksionimin dhe mënyra e përdorimit të tyre.


Kontrolli para përdorimit: shikohet automjeti dhe konstatohet se a janë në rregull pneumatikët dhe se mos ka rrjedhje të lëngjeve nën automjet. Hapet hauba (*kapaku i motorit*) e automjetit për të kontrolluar: nivelin e lëngut për ftohje, nivelin e vajit të sistemit të frenimit dhe të vajit në motor, si dhe mos ka rrjedhje vaji nga motori ose nga ndonjë pajisje tjetër.

Kandidati për shoferë njoftohet si bëhet hyrja dhe dalja në automjet, rekomandohet se gjatë hyrjes në automjet ecja të bëhet në drejtim të kundërt të lëvizjes së automjeteve.

Pas instruksioneve të sipërsëhënuar kandidati hynë në veturë, dhe sigurohet se dyert e veturës janë mbyllur, kjo mund të vërtetohet edhe nëpërmjet pajisjeve itelegjente apo mekanikisht. Pasi të ulët kandidati për shoferë së pari rregullohet ulësja, pastaj pasqyrët, mbështetësit për kokë nëse janë në dispozicion dhe në fund vendoset rripi i sigurisë.

Pozita e trupit në ulëse

Instruktori i tregon kandidatit si rregullohet pozita e ulëses në mënyrë të drejtë e cila bazohet në tri pika e që varet nga gjatësia e kandidatit, siç është paraqitur në figurat vijuese. Krahas pozitës së drejtë instruktori demonstroi edhe pozitën e jo të drejtë dhe pasojat e kësaj pozite.



Pozita e drejtë




Pozita jo e drejtë



Pozita jo e drejtë

Rregullimi i ulësës bëhet në atë mënyrë se kur shtypet pedalja, këmba duhet të jetë në pozitë pak të kërrusur, që do të thotë se nuk është plotësisht e zgjatur siq është paraqitur në figurën vijuese.



Pozita në ulëse

Pozita e durve në sistemin drejtues-timon

Pozita e drejtë në timon duhet të jetë në kordinim me pozitën e trupit dhe këmbëve. Pozita e durëve në timon i përgjigjet akrepave të orës: **9 dhe 15 ose 10 dhe 2**. Ndërsa gjatë ndërrimit të shpejtësis dora e majtë të jetë në timon në pozitë të akrepave të orës **12:00**.



Pozita e drejtë e durve në timon



Pozita jo e drejtë e durve në timon

Pozita e dorës në dorzën e ndërruesit të shpejtësisë gjatë ndërrimit të shkallëve të transmisionit është paraqitur në figurat vijuese.



Pozita e dorës në dorzën e ndërruesit të shpejtësisë

Ekzistojnë lloje të ndryshme të komandës së ndërruesit të shpejtësisë, kandidati njoftohet për mënyrën e funksionimit.

Instruktori me kandidatin duhet të ushtrojë manipulimin me komandat e dorës deri në nivelin e automatizimit, kur kandidati i kryen lehtë veprimet me komandat e dorës pa i shikuar ato.

Rregullimi i pasqyreve

Rregullimi i paqyrëve në mënyrë të drejtë ka rëndësi të madhe nga aspekti i sigurisë rrugore. Me ndihmën e pasqyrëve kandidati për shoferë kontrollon trafikun anash dhe nga prapa.

Në figurat vijuese janë paraqitur mënyra e drejtë dhe jo e drejtë e rregullimit të pasqyrëve.



Rregullimi i pasqyres në mënyrë të rregullt



Rregullimi i pasqyrës në mënyrë të jo të rregullt

Rregullimi i pasqyrëve bëhet varishtë aftësisë së kandidatit kryhet brenda apo jashtë vendbanimit. Brenda vendbanimit pasqyret rregullohen se të shikohet sa më afër nga prapa, ndërsa jashtë vendbanimit të shikohet sa më largë.

Shikimi mbi supe (këndi i vdekur)



Kandidatit duhet ti sqarohet rëndësia e shikimit mbi supe i ashtuqujtur “ *Këndi vdekur*”, ku në një pozitë nuk vërehet automjeti nëpërmjet pasqyrëve anësore. Është me rëndësi te kandidati të krijohet shprehi se para hyrjes në ndonji veprim me mjet që rregullisht të shikoj mbi supe.

Këndi i vdekur

Puna me komandat e këmbës





Instruktori i sqaron kandidatit punën e komandave të këmbës si bëhet shtypja dhe lëshimi i tyre (gazit, friksionit dhe frenit) dhe koordinimin e tyre, gjatë nisjes nga vendi, gjatë ndërrimit të shkallëve të shpejtësive, gjatë ngasjes prapa, gjatë ngadalësimit dhe ndaljes së automjetit dhe veprimeve tjera me automjetet. Instruktori i sqaron kandidatit se shtypja e komandave bëhet me shputat e këmbës.

Pozita e këmbës në komand të automjetit -shypja



Instruktori i sqaron kandidatit si bëhet lëshimi i komandave varësisht nga funksioni i tyre.

Pozita e këmbës në komand të automjetit -lëshimi



Sipërfaqja shkelëse gjatë manipulimit dhe komandimit me shputat e këmbës është dhënë në vijim:

Sipërfaqja shkelle gjatë manipulimit

- Manipulimi i shpejtë, por me pakë forcë (1),
- Manipulimi i shpejtë, me forcë të madhe (2), dhe
- Manipulimi i ngadalshme, por me forcë maksimale (3).

Kandidatit i tregohet si bëhet koordinimi i komandave të këmbës- friksionit dhe gasit gjatë nisjes nga vend, me rastin e ndërrimit të shkallave të shpejtësive nga ulëta në të lartën dhe anasjelltas. Para fillimit të ushtrimeve me komanda duart në timon janë të vendosura në mënyrë të drejtë, ndërsa këmbët anash komandave - pedaleve.

Friksioni shtypet me këmbën e majtë dhe lëshohet në mënyrë graduale te shpejtësit e ulëta, pas lëshimit të pedaljes këmba zhvendoset anash nga pedalja e friksionit.

Pedalja e gasit dhe frenimit shtypet me këmbën e djathtë. Këmba e majtë është e mbështetur në thembër dhe lëvizja bëhet në nyjen e thembrës. Pedalja shtypet dhe lëshohet me lëvizje të ngadalshme.


Gjatë frenimit këmba - shputa plotësisht vendoset mbi pedale. Gjatë lëshimit të pedaljes, këmba është e ngritur nga dyshemeja. Pedalja në mënyrë graduale shtypet dhe lëshohet.

Kyçja dhe çkyçja e motorit

Kandidati i sqarohet se automjeti duhet të jetë i siguar nga vetëlëvizja (përmes frenit të parkimit) pavarësisht se rruga a është në pjerrtësi gjatësore dhe ndërruesi i shpejtësisë duhet të jetë në pozitën lerë (me shtypjen e pedaljes të friksionit ndahet motori nga ndërruesi i shpejtësive që të mos ngarkohet tepër anllaseri për shkak të lëvizjes së dhëmbëzorëve në ndërruesin e shpejtësive sidomos në kushtet dimërore kur vaji i ndërruesit trashet).

Kandidatit i sqarohet si bëhet kyçja (ndezja) e motorit gjatë sezonit veror dhe dimëror, duke pasur parasysh edhe përdorimin e pajisjeve teknologjike të avancuar nëse është i pajisur automjeti. Pastaj bëhet sqarimi se si bëhet ç'kyçja e motorit. Duke pasur parasysh se ka lloje të ndryshme të automjeteve me te cilat bëhen aftësimi i kandidatit për shoferë, instruktori i tregon dhe vetë e demonstron kyçjen dhe çkyçjen e motorit duke i përfshirë pajisjet itelengjente.

Motorin nuk e nxejmë në vend por në lëvizje e sipër, duke mos e rënduar motorin në minutat e parë të ngasjes.



Kyçja e motorit


Ushtrimi me pedalen e friksionit- gjysmë friksionit.

Kandidatit i sqarohet se kur pedalja e friksionit është e shtypur është e ndarë lidhja e motorit dhe ndërruesit të shpejtësisë (sistemi i transmisionit). Me rëndësi është kandidatit të kuptojë lëshimin e pedaljes së friksionit deri te “*pika e veprimit*”. Ushtrimi bëhet së pari me motor të çkyçur në vend.

Ky veprim paraqet vështirësi të kandidati dhe nuk mund të shkohet me veprimet e më tutjeshëm pa e kuptuar mirë ushtrimin e gjysmë friksionit.

Pasi që kandidati ka kuptuar metodën e gjysmëfriksionit kalohet në ushtrimin e nisjes së automjetit nga vendi dhe ndërrimi i shpejtësive.

Nëse automjeti është i pajisur me teknologji të avancuar bëhet sqarimi i përdorimit të këtyre pajisjeve.



Shtypja e friksionit

Kandidati duhet të kuptojë nëse lëshohet pedalja e friksionit shpejtë, vjen deri te dridhje e motorit, ose nuk ipet gasi i mjaftueshëm mund të vij deri te fikja e motorit.

Përdorimi i sistemit të frenimit

Freni punues- këmbës

Frenimi me fren punues (këmbës) bëhet në mënyrë graduale (ngadalësimi) p.sh në situatat ku duhet të veprohet sipas rregullave të trafikut dhe sigurisë, ndërsa frenimi i vullshëm lejohet vetëm në rast rrezikut të drejtëpërdrejtë.

Freni ndihmës- i tregohet kandidatit si përdoret në rast të mos funksionimit të frenit punues.

Freni i parkimit- i tregohet kandidati si sigurohet automjeti i ndaluar nga vetëlëvizja, së pari e demonstron vetë, pastaj e bënë kandidati për shoferë. Kandidatit i sqarohet si bëhet ngadalësimi i automjetit varësisht nga situatat në trafikun rrugë dhe me çfarë force veprohet mbi pedalën e frenit punues.

KAPITULLI I III

AFTËSIMI I KANDIDATIT NË POLIGON

AFTËSIMI FILLSTAR NË POLIGON

Plani dhe përgatitja për realizimin e orës mesimore përbëhet prej këtyre elementeve:

- *Njësia mësimore (tema),*
- *Vendi i realizimit së mësimimit,*
- *Mjetet mësimore,*
- *Metodat mësimore,*
- *Koha e nevojshme për kryerjen e temes,*
- *Materiali mësimor,*
- *Ora mësimore e aftësimit nga pjesa praktike zgjatë 45 minuta.*

Rrjedha e orës mësimore

Pjesa hyrëse e orës mësimore

Në pjesën hyrëse të orës mesimore instruktori duhet që të bisedoj me kandidatin rreth përgatitjes së kryerjes së njesisë së re mësimore. Pas kësaj kandidati kryen kontroll vizuale të automjetit dhe së bashku me instruktorin përcaktojnë marshutën- ku do të zhvillohet pjesa praktike e aftësimit.

Detyrat e instruktorit para fillimit të ngasjes

Detyrat e instruktorit para fillimit të ngasjes që t'i sqaron kandidatin janë:

- *Masat paraparke para nisjes së automjetit,*
- *Kushtet për nisjen e automjetit nga vendi,*
- *Nisja me shpejtësinë e parë (shkalla e parë e transmisionit),*
- *Nisja nga vendi,*
- *Ndalja e automjetit.*

Aftëson kandidatin për ngasjen para, mbrapa dhe ndalja në vijën e ndaljes.

Nisja e automjetit nga vendi

Kandidatit i sqarohet si bëhet nisja e automjetit nga vendi duke përdorur metodën e gjysëmfriksionit, dhe kordinimin e pedaleve të këmbëve atë të friksionit dhe gasit. Kandidati është më rëndësi të kuptoj “pikën e veprimit (lidhjes)” kur fillon lidhja e motorit me transimisionin (kur motori fillon të dridh), lëshohet ngadal pedalën e friksionit, pasi automjeti fillon të lëviz duke jep gas në mënyrë graduale. Ka lloje tipe te automjeti që gjatë nisjes nuk ka nevojë të japim gas vetëm e lëshon friksionin deri te pika e veprimit, pastaj vazhdohet me lëshuarjen e fiksionit ku automjeti fillon lëvizjen.

Instruktori mund të përdor çfarëdo metode për nisjen e automjetit nga vendi, vetëm që nisja të bëhet në mënyrë graduale nga vendi dhe që pamundëson fikjen e motorit apo nisjen e automjetit në mënyrë jo të rregullt.

Ndaljen e automjetit kandidati e bënë në këtë mënyrë:

- Vështron trafikun nga prapa,
- Zvogëlon shpejtësinë sipas nevojës,
- Zgjedhja e vendit ku do të ndalet,
- Sinjalizimi me tregues të drejtim,
- Ndalet mjeti dhe sigurohet automjeti nga vetëlëvizja.

Teknika e ndërrimit të shpejtësive

Pas kandidati ka treguar se mund të niset me automjet nga vendi, fillohet me fazën e ndërrimit të shpejtësive nga e vogëla në të lartën dhe anasjelltas.



Ndërrimi i shpejtësisë nga e I-II

Në shkallën e parë të transmisionit lëvizet me automjet prej 10 deri 15 km/h, duke përcjellur numërin e rrotullimeve të motorit, zhurmën e motorit, shpejtësinë e ngasjes, apo pajisjet inteligjente, që janë të ndërlidhura me parametrat teknike të motorit të automjetit dhe kushteve të rrugës.

Komandat e dorës -këmbëve



Tregues i rrotullimeve të motorit... 2000-3000 rrot.../minut.... 2500 rrot... /min –varet nga lloji dhe fuqia e motorit. Numri i tregueseve të rrotullimeve mund të jetë edhe në mënyrë digjitale.

Tabela instrumentale

Kandidati përcaktohet cila nga metoda e lartë cekura të përdor gjatë ndërrimit të shpejtësisë.



Pasi është arritur shpejtësia e mjaftueshëm shtypet pedalja e friksionit shpejtë deri fund, dorëza e ndërruesit vihet në shkallën e II të shpejtësisë, lëshohet ngadal pedalja e friksionit, duke koordinuar veprimet me pedale të gasit- duke rritur fuqinë e motorit dhe automjeti pa dridhje vazhdon lëvizjen.

Shpejtësia e parë përafësisht 10-15 km/h

Në shpejtësinë e dytë lëvizet për afërsisht prej **15 deri 30 km/h**, e që varet nga parametrat teknike të motorit të automjetit. Instruktori në bazë të parametrave të motorit përdorë metodën më të përshtatshme për kandidatin.



Ndërrimi i shpejtësisë nga e II-III

Gjatë ndërrimit të shpejtësive nga e dyta në të tretën, veprimet janë të njëjta siq është cekur më lartë. Pasi automjeti ka arritur nxitimin e duhur (përafërsisht 35-deri 45 km/h, varet nga kushtet dhe rrethanat e rrugës),

shtypet friksioni deri në fund, dorzën e ndërruesit të shpejtësisë e vëjmë në pozitën e tretë, lëshohet pedalja e frisionit, shtypet pedalja e gasit në mënyrë graduale.



Shpejtësia e tretë përafërsisht prej 35-45 km/h..... deri 60 km/h

Ndërrimi i shpejtësive nga e III-IV



Gjatë ndërrimit të shpejtësive nga e III- në të IV-ën, veprimet janë të njëjta siq është cekur më lartë. Pasi automjeti ka arritur nxitimin e duhur, shtypet friksioni deri në fund, dorzën e ndërruesit të shpejtësisë e vëjmë në pozitën e IV-të, lëshohet pedalja e friksionit, shtypet pedalja e gasit në mënyrë graduale. Me këtë shpejtësi lëvizet mbi 60 km, gjë që varet nga kufizimet që vlejné për rrugën përkatësisht për pjesën e rrugës dhe rrethanat tjera në trafik.

Shpejtësia e katërt përafërsisht prej 60 km/h.....

Ndërrimi i shkallëve të transmisionit me V apo më shumë shpejtësi

Teknika e ndërrimit me V apo më shumë shpejtësi e njëjet si gjatë ndërrimit të shpejtësisë për të kaluar nga III në të IV-ën.

Teknika e ndërrimit të shkallëve të transmisionit nga e larta në të ultën është e njëjtë si nga e ulta deri te e larta, por tani duhet të zvoglohet shpejtësia përafërsisht 10 km/h më pak se sa është nevojitur nxitimi të kalohet nga një shpejtësi e ulët në një shpejtësi më të lartë.

Kandidatit duhet të sqarohet se prej ndërrimit të shpejtësisë nga e II- I, së pari duhet të shtypet friksioni e pastaj pedalja e frenimit.

T1. KONTROLLIMI DHE PËRGATITJA E MJETIT RRUGOR PËR NGASJE

Kandidati për shoferë pas aftësimit në poligon vazhdon aftësimin në rrugë publike. Paraprakisht para se të filloj ngasjen në rrugë publike siç u cekë më lartë, së pari bëhet shikimi vizual i automjetit, kontrollohet gjendja e pneumatikëve, gjendja e karoserisë ndonjë dëmtim eventual, pasqyrëve të jashtme, fshisave, xhamit ballor, tabelat e regjistrimit, pastaj bëhet kontrolli teknik preventiv ditor, i nivelit të lëngut për ftohjen e motorit, vajit të motorit, vaji për frenim, rripave, bateris, si dhe kontrollet tjera të rëndësishme.



Kontrollimi i sasisë së vajit në motor

Kontrollimi i sasisë së vajit bëhet kur automjeti është në sipërfaqen e rrafshhtë dhe motori është i ftohët. Nëse sasia e vajit është e pamjaftueshme i qitet vaji si në figurën vijuese.



Mbushja e vajit në motor

Varsishtë nga stinët e vitit dhe lloji i automjetit përdoret vaji i motorit, duhet të shikohet libri i mirëmbajtjes së automjetit.

Kandidatit i tregohet nëse motori i automjetit e ka kaluar kufirin e lejuar dhe u ndezë drita e kuqe, nuk lejohe të hapet kapaku i rezervarit të ujit / lëngut, pasi që uji/ lëngu i nxehtë mund të bije ftyrës, prandaj duhet pritur deri sa motori ftohet e pastaj të kontrollohet sasia e ujit/lëngut në te.

T2. VEPRIMI I PARË (1) DHE I DYTË (2) SIPAS SHTOJCËS PËRKATËSE TË UDHËZIMIT ADMINISTRATIV PËR DHËNIEN E PROVIMIT

Ushtrimet në poligon

Aftëson kandidatin për ngasjen para, mbrapa dhe ndalja në vijën e ndaljes


Ngasja përpara dhe mbajtja e drejtimit deri te vija e ndaljes- kandidati i tregohet masat dhe pikën orientues për ndaljen e automjetit siç parashihet me rregullore në fuqi.

Nisja bëhet nga starti i vijës siç shihet në figuren vijuese.


Kandidati nga pozita fillestare (START) e drejton mjetin duke bërë ndërrimin e shkalleve të transmisionit nga e parë në të dytën dhe duke mbajtur drejtimin brenda hapësirës së kufizuar deri te vija ndalese (STOP) në gjerësi prej 0,5 metra ku duhet të ndalet. Pjesa më e skajshme në pjesën e përparme të mjetit duhet të jetë brenda kësaj gjerësie (shih foton).



Vija e startit



Vija ndalëse nga prapa



Vija ndalëse nga prapa


Ngasja prapa dhe mbajtja e drejtimit deri te vija e ndaljes- kandidati i tregohet masat dhe pikën orientues për ndaljen e automjetit gjatë lëvizjës prapa siç parashihet me rregullore në fuqi.

Kandidati lëvizë prapa me mjet në hapësirën e kufizuar nga vija ndalese (STOP) dhe vazhdon deri në pikën fillestare (START) ku duhet të ndalet në gjerësi prej 0,5 metra. Pjesa më e skajshme në pjesën e pasme të mjetit duhet të jetë brenda kësaj gjerësie.

T3. VEPRIMI I TRETË SIPAS SHTOJCËS PËRKATËSE TË UDHËZIMIT ADMINISTRATIV PËR DHËNIEN E PROVIMIT


Aftëson kandidatin për parkim në varg (paralelë) në mes të dy mjeteve

Parkimi i automjetit-parkimi i automjetit është paraqitur në figure vijuese. Kandidati me automjet lëvizë prapa deri sa nuk barazohet pjesa e pasme e automjetit te tij me automjetin tjetër (mund të jetë kon, apo diq tjetër e improvizuar) pastaj fillon ta lëviz prapa, pasi që automjeti kalon në këndin 45 shkallë, kthehet timoni i automjeti ne anën e kundërt deri sa automjeti hynë ndërmjet dy automjeteve siç shihet në figurë.



Parkimi i automjetit paralel


Parkimi i automjetit paralel bëhet edhe nëpërmjet pajisjeve teknologjike, kandidati i sqarohet përdorimi i tyre me rastin e parkimit dhe daljes nga parkimi.



Parkimi me pajisje itelegjente

Kandidati e sjell mjetin në pozitën 1 dhe me ngasje përpara ngas deri te pozita 2, pastaj me ngasje prapa parkon mjetin djathtas në vendin e caktuar (pozita 3) në mes konave. Kandidati duhet të sinjalizoj, përcjell situatën dhe shfrytëzoj pasqyrat e shoferit. Të gjitha dritaret në mjet duhen të jenë të mbyllura.

Parkimi kryhet në mënyrë të rregullt në qoftë se kandidati ka vendosur mjetin në vendin e caktuar dhe paralel me vijën në distancë deri 40cm.



Poligoni

Në poligon demonstron si të bëhet dalja nga vendparkingu si në rrugë publike.

Kandidati për shoferë aftësohet në poligon si ndalet automjeti duke demonstruar veprimet si në vijim:



Foto- ndalja e automjetit

- Vështrimi i trafikut prapa,
- Zgjedhja e vendit ku do të ndalet,
- Sinjalizimi me tregues të drejtimit,
- Lirimi i pedales së gasit,
- Shtypja e pedaljes së friksionit,
- Ndalja e automjetit,
- Ndezja e të gjithë treguesit.

Ngasja e pavarur në poligon

Pas konstatimit se kandidati për shoferë ka arritur progres në aftësim, instruktori organizon ngasjen e pavarur në poligon, kandidatit vetëm në automjet i bënë ushtrimet duke krijuar shprehi gjatë hyrjes dhe daljes nga trafiku, sikurse të ngas automjetin në rrugë publike.

Pjesa përfundimtare e orës mësimore

Pas përfundimit të ngasjes, kandidati në mënyrë të drejtë e parkon automjetin dhe e siguron automjetin me frenin e parkimit nga vetë lëvizja, dorëza e ndërruesi vihet në shpejtësinë e parë nëse është në përpjetë apo rrafshë ose në pozitën për lëvizje prapa (likferc) në teposhtëze. Pastaj së bashku me instruktorin analizojnë orën mësimore. Instruktori e njofton dhe njëkohësisht e udhëzon kandidatin nëse disa pjesë të veprimeve në orën mësimore nuk kanë qenë në nivel të duhur, duke i rekomanduar që në orën vijuese të ushtroj ato veprime të cilat nuk i ka zotëruar plotësisht.

Shofer instruktori i cakton orët për temat – njësit mësimore kandidatit për shofer varësisht nga aftësimi i tij.

KAPITULLI I -IV

AFTËSIMI BRENDË DHE JASHTË VENDBANIMIT (PËR LICENCIM DHE PËRTRITJE TË LICENCËS)

AFTËSIMI BRENDA DHE JASHTË VENDBANIMIT

Pasi kandidati për shofer ka treguar rezultat pozitiv gjatë veprimeve në poligon fillon aftësimin në rrugë brenda vendbanimit. Instruktori në fillim të orëve praktike e shfrytëzon rrugën me intesitet të dobët të trafikut.


Fillohet me ngasje me ndërrim të shpejtësive prej më të ultës deri në më të lartën dhe anasjellas. Instruktori zgjedhë pjesën e rrugës kur ka mundësi kandidati që të bëjë ndërrimin e shkallëve të transmisionit sa më lehtë, duke përfshirë: *mbajtjen e drejtë të pozitës së automjetit në shiritin e trafiku, për dalje nga trafiku, ndalja dhe lëshimi i mjetit.*

Hyrja dhe dalja nga trafiku

Kandidati ushtrohet si bëhet hyrja dhe dalja nga trafiku duke demonstruar në poligon apo ndonjë sipërfaqje të rrugës ku nuk zhvillohet trafiku publik. Të krijoj shprehi kandidati gjatë ushtrimit për hyrje dhe dalje nga trafiku sikur në situatat reale në trafik.

Kandidatit i sqarohet radhitja e veprimeve para hyrjes në trafik si në vijim:

- Shtypet friksioni deri fund,
- Vendoset ndërruesi i shpejtësisë në shpejtësinë e parë,
- Vështrohet trafiku përpara, anash nga prapa dhe shikimi këndë të vdekur,
- Sinjalizohet me tregues të drejtimit,
- Lëshohet pedalja e friksionit deri te “pika e veprimit”,
- Lëshohet freni i dorës,
- Bëhet hyrja në trafik.



Hyrja në trafik

Kandidati i sqarohet se dalja nga trafiku bëhet duke përdorur disa nga medodat e lartë cekura si me rastin e hyrjes në trafik.

Shpejtësia e lëvizjes

Kandidatit për shoferë duhet sqaruar ti përmbahet kufizime të shpejtësive të përcaktuar me rregullat e trafikut, me shenja të trafikut, sipas kategorive të rrugëve apo kategorive të automjeteve.

Gjatë aftësimit praktik nuk lejohet tejkalimi i shpejtësisë së lëvizjes në asnjë rast.

Gjatë aftësimit praktik kandidati duhet t'ua përshtatë shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe fushëpamjes së rrugës, gjendjes dhe llojit të rrugës, kushteve teknike, kushteve atmosferike, ngarkesës së mjetit, dendësisë së trafikut, gjendjes psikofizike të tij dhe aftësive personale të tij, ashtu që të jetë në gjendje ta ndalë mjetin para çdo pengese që mund të paraqitet në kushte të dhëna brenda kufijve të fushëpamjes, përkatësisht, të mund të veprojë me kohë.

Shpejtësia më e madhe e lejuar brenda vendbanimit



Gjatë aftësimit praktik të kandidatit për shoferë brenda vendbanimit nuk ka kufizim të shpejtësisë me shenja të trafikut lejohet ngasja deri 50 km/h.

Lëvizja në zonë urbane

Frenimi dhe nxitimi i vullshëm


Gjatë ngasjes kandidati për shoferë duhet kuptoj tekniken e frenimit, si e bënë frenimin për t'i respektuar rregullat e trafikut dhe sinjalizimin rrugorë, situatat që janë qartë në trafik i ashtuqytur frenim i lirë, pastaj frenimin e vullshëm lejohet vetëm në ndonjë situatë në trafikun rrugor që konsiderohet e rrezikshme. Kandidatit për shoferë nuk i lejohet nxitimi i vullshëm në asnjë rast.



Lëvizja brenda vendbanimit

Kandidati për shoferë i sqarohet se duhet të ketë parasysh se mund të dal ndonjë person në mesë automjeteve të parkuar ose të hapet dera nga ndonjë automjet i parkuar. Për këtë arsye duhet të mbaj distancën e sigurisë terthore të mjaftueshme. Ndërsa distanca gjatësore duhet të jetë së paku një (1) sekond ndaj automjetit (kombit) që lëvizë përpara.

Në rrugën për lëvizje të mjeteve në të dy kahet, e cila ka katër (4) apo më shumë shirita të trafikut, kandidatit nuk i lejohet të kalojë me mjetin e vet në shiritin rrugor që shërben për lëvizje të mjeteve nga kahu i kundërt (shih foton e më sipërme).



Rruga me tre shirita trafikut në dy kahe

Kandidatit për shoferë ka të drejtë të lëvizë vetëm në shiritin e djathtë të skajshëm në drejtim të lëvizjes, pasi që me sinjalzim horizontal e ka të ndaluar të përdor shiritin e mesëm.



Ngasja prapa

Kandidatit i lejohet lëvizja prapa me automjet, por duhet ti ndezë të gjithë treguesit e drejtimit dhe në pjesën e shkurtë të rrugës.

T4 NDALJA E AUTOMJETIT

Ndalja e automjetit

Ndalja e automjetit bëhet duke koordinuar komandat e këmbës, duke pasur në konsiderat se ndalja të bëhet në mënyrë graduale, shtypet pedalja e friksionit pastaj frenohet jo vrullshëm deri te ndalja e plotë e mjetit, gjatë veprimit sinjalizohet me treguesit e drejtimit. Instruktori duhet të ketë parasysh për kryrjen e këtij veprimi të zgjedh pjesën e rrugës me intesitet të vogël duke mos e penguar rrjedhjen normale të trafikut. Nëse nuk ka kushte për një veprim të tillë në rrugë, zgjedh ndonjë sipërfaqe pranë rrugës publike ku lejohet parkimi apo të ngjajshme. Instruktori duhet të vlerësoj teknikën e kandidatit gjatë ndaljes së automjetit me rastin e respektimit të rregullave të trafikut dhe sigurisë dhe sinjalizimit rrugor.

Gjatë daljes nga parkingu duhet të kemi kujdes majtas, pasi që shiriti në të cilin synojm të kthehem majtas mund të jetë ndonjë automjet në tejkalim e sipër apo ndonjë automjet i cili lëvizë po në këtë shirit ta rrisë shpejtësinë e lëvizjes (vjen nga kahu i djathtë) që rrezikon sigurin e trafikut rrugor.



Hyrja në trafik nga vendparkimi



Hyrja nga vendparkimi

T5. MARRJA E MASAVE TE NEVOJSHME GJATË DALJES SE MJETIT DHE DALJA NGA VEND PARKIMI, VAZHDIMI I LËVIZJES PAS NDALJES SË MJETIT NË TRAFIK, DALJA NGA OBORRI

Detyrat e instruktorit:

- *Demonstron hyrjen e sigurt në automjet pa penguar pjesëmarrësit tjerë në trafik;*
- *Siguron daljen e sigurt nga automjeti;*
- *Demonstron daljen e sigurt në automjet pa penguar pjesëmarrësit tjerë në trafik;*
- *Siguron automjetin nga vetëlëvizja dhe përdorimi nga personat e paautorizuar;*
- *Siguron daljen e pasagjerëve nga ana ku nuk zhvillohet trafiku.*

Instruktori i sqaron kandidatit se para se të hap derën duhet vështruar trafikun nga prapa nëpërmjet pasqyrëve (të brendshme, anësore) dhe këndin e vdekur. Pasi të sigurohet se nuk i pengon dhe i rrezikon pjesëmarrësit tjerë në trafike hap derën e automjetit.



Gjatë daljes nga vetura, shoferi duhet të shikon trafikun nga prapa, përmes pasqyrëve dhe këndit të vdekur dhe derën e hap me dorë të djathtë.

Hapja e derës në mënyrë jo të rregullt



Hapja e derës jo në rregull duke rrezikuar biçiklistin



Kandidatit për shoferi i tregohet se me rasti e hyrjes në rrugë nga oborri i shtëpisë, duhet t'i lëshojë këmbësorët të cilët janë duke lëvizur nëpër trotuar.

Këmbësorët kanë përparësi kalimi


Shofer instruktori obligohet t'i tregoj kandidatit për shoferi se çdo herë para ngasjes të bëjë shikimin vizual për rreth veturës, se mund të vijë në situatat e papritshme sikurse kjo në foton vijuese.



Ngasja prapa e rrezikshme

Këndi i vdekur - ang. BLIND SPOT (shikimi mbi supe) me pajisje itelegjente

Këndi i vdekur paraqitet te pjesët anësore dhe të prapme të veturës, gjatë ngasjes nuk shihet automjeti i



cili gjendet në këtë zonë me anë të pasqyrave, andaj duhet shikuar mbi supe - me kthim koke majtas /djathtas për të shikuar se mos ka ndonjë mjet në zonën e këndit të vdekur.

Shoferit nuk i lejohet të bëjë asnjë veprim pa e shikuar këndin e vdekur, pasi që mund të jetë ndonjë mjet rrugor në këtë zonë dhe mund të shkaktohet aksidenti.

Këndi i vdekur në veturë – me ngjyrë të kuqe

Automjetet e reja janë pajisura me sistem inteligjent të ashtuquajtur "Blind Spot Assist", p. sh. i Mercedes-it, mund të aktivizojë edhe frenat për të shmangur një aksident. Më saktësisht, ESP-i do të reagojë duke frenuar rrotat në njërën anë, duke parandaluar ose ngadalësuar kalimin në shiritin tjetër të trafikut.

Në rrugë me tre shirita trafiku për një kahe kur shoferi është duke lëvizur në shiritin e mesëm e do që ta ndërrojë shiritin e trafikut djathtas apo majtas, pajisjet inteligjente i'a lehtësojnë një veprim të tillë, dhe nëse ka ndonjë automjet në zonën e këndit të vdekur e detektojnë atë dhe e sinjalizojnë shoferin.

Në fotot e mëposhtme është paraqitur radhitja e veprimeve para se të ndërmerret ndonjë veprim me automjet.



Radhitja e veprimeve para se të ndërmerret ndonjë veprim në trafik është:

1. Shikimi në pasqyrën e brendshme.
2. Shikimi në pasqyrën e jashtme,
3. Shikimi në këndin e vdekur.
4. Dhënia e treguesve të drejtimit.


Radhitja e veprimeve për vështrimin e trafikut nga prapa

Hyrja në rrugë

Detyrat e instruktorit janë:

- **Jep instruksione për hyrjen në rrugë dhe nga parkimi pas ndaljes së automjetit**
- **Siguron hyrjen e sigurt në trafik të automjetit;**
- **Demonstron dhënien e përparësi kalimit trafikut rrjedhës.**

Instrukcionet për kandidatin për këtë situatat janë:



- të sinjalizoj me treguesin e majtë të drejtimit,
- duhet shikuar dy anët e rrugës,
- të hyjë në rrugën qarkulluese vetëm pasi nuk i pengon dhe nuk i rrezikon pjesëmarrësit tjerë në trafik.

Hyrja në trafik nga rruga e dheut

Aksidenti i trafikut

Detyrat e instruktorit janë:

- Jep instruksione në rast të aksidentit;
- Sigurimi i vendit të aksidentit;
- Masat për ruajtjen e gjurmëve të aksidenteve;
- Vendosja e shenjës së pajisjes së sigurisë (treëndëshi i sigurisë);
- Ofrimi i ndihmës së parë të lënduar.

Distanca e sigurisë

Detyrat e instruktorit:

- Jep instruksione për distancën anësore dhe gjatësore të sigurisë;
- Demontron mundësinë e hapjes së dyerve nga automjetet e parkuara dhe rreziqet;
- Demontron daljen e këmbësorëve në mes të mjeteve të parkuara dhe rreziqet.



Distanca gjatësore e sigurisë

Distanca e sigurisë gjatësore ndërmjet automjeteve gjatë ngasjes brenda vendbanimit është 1 sekond, jashtë vendbanimit duhet të jetë së paku 2 sekonda, ndërsa në rrugë të rrëshqitshme 3 sekonda.



Distanca tërthore e sigurisë

Distanca e sigurisë terthore është së paku një (1) metër nëse tejkalohet mjeti me dy rrota, kolona e organizuar e këmbësorëve.

Ndërsa gjatë ngasjes pranë mjetit të ndaluar apo të parkuar të jetë e mjaftueshme se në rast hapjes së derës së tyre, të mos rrezikohet siguria në trafik (shih foton).

T6. KRYQËZIMI, AFRIMI NE KRYQËZIM DHE NYEJVE SI DHE KALIMIN NË TO

Trafiku në kryqëzim

Instruktionet për kandidatin për shofer kur i afrohet kryqëzimit janë: duhet të lëvizë me kujdes të shtuar, në mënyrë që t'iu përshtatet kushteve të trafikut në kryqëzim dhe ta kuptojë mënyrën e rregullimit të trafikut në kryqëzim.

Kur shoferi i mjetit i afrohet kryqëzimit, ai është i obliguar të lëvizë me shpejtësi të tillë që të mund të ndalet dhe t'i lëshojë pjesëmarrësit e trafikut të cilët kanë përparësi kalimi në kryqëzim.



Trafiku në kryqëzim i bllokuar


Kandidatit për shofer nuk i lejohet hyrja në kryqëzim pasi është ngec (bllokue) trafiku.

Rregulla e krahut të djathtë


Kandidati për shofer e zvogëlon shpejtësinë dhe i japë përparësi kalimi veturës së verdhë (rregulla e krahut të djathtë).




Vetura e verdhë ka përparësi kalimi



Vetura e kuqe kthehet majtas - lëviz e fundit




Kandidati për shoferë vazhdonë lëvizjen para veturës së kuqe drejtë apo djathtas, por duhet me pas kujdes se vetura e kuqe mund të kthehet majtas edhe pse nuk ka drejtë.




Vlenë rregulla e krahut të djathtë

Kandidati për shofer i jep përparsi kalim veturës se gjelbërt, ndërsa lëvizë para veturës së kuqe.



Kryqëzimi i rregulluar me shenja të trafikut



Kryqëzimi i rregulluar me shenja e trafikut




Kandidati për shofer i jep përparsi kalim mopedit pasi lëviz në rrugën kryesore, pastaj tramvajit.



Kandidati për shofer duhet të ndalet para vijës së ndalje **STOP**- pasi të kalon biçiklisti vazhdon lëvizjen e dytë në kryqëzim.


Unë duhet të ndalem para shenjës STOP



Kandidati për shofer vazhdon lëvizjen e parë në kryqëzim, pasi që mban drejtimin e lëvizjes (rregulla e krahut të djathtë).

Unë lëviz para veturës së kuqe

Shtrirja e rrugës me përparësi kalimi




Kandidati për shofer vazhdon lëvizjen e fundit në kryqëzim, pasi që vetura e kuqe dhe biçiklisti vjen nga krahut i djathtë i tij (zbatohet rregulla e krahut të djathtë).

Shtrirja e rrugës me përparësi kalimi është në anën e djathtë



Kandidati për shofer ndalet para kryqëzimit dhe vazhdon lëvizjen pas kalimit të veturës së gjelbër e cila lëviz në shtrirje të rrugës me përparësi kalimi (kryesore).



Vetura e gjelbër ka përparësi kalimi



Në këtë kryqëzim kandidati për shofer lëviz i pari në shtrirje të rrugës me përparësi kalimi dhe duhet të sinjalizoj me tregues e drejtimit

Unë lëviz i pari

Kryqëzimi i rregulluar me semaforë



Në këtë kryqëzim kandidati për shofer lëviz i pari pasi që respektohet domethënia e dritave në semafor e jo shenja e trafikut STOP. Duhet pasur kujdes se vetura e kuqe mund të kthehet djathtas edhe pse nuk ka drejt.

Unë vazhdoj lëvizjen pa u ndalur



Kandidati duhet te ndalet para kryqëzimit pasi respektohet domethënia e dritave në semafor e jo shenja e trafikut” **Rruga me përparësi kalimi**”.

Respektohet semafori



Respektohet shenja e trafikut “ **STOP** ”

Drita e verdhë përparësinë vezulluese nuk e rregullon përparësin e kalimit dhe aplikohen rregullat tjera të përparësisë kalimit.



Nëse ekziston vija tërthore e plotë ndalëse duhet të ndalet para kësaj vije. Nëse nuk ekziston vija ndalëse e plotë, kandidati ndalet detyrimisht vetëm te vija e të pamurit në kryqëzim (**nuk ka nevojë të ndalet para shenjës STOP**).

Ndalja e automjetit bëhet te vija e pamurit

Kryqëzimi me rreth rrotullim

Në kryqëzim me rrethrrrotullim vlejné rregulla të njëjta sikurse në kryqëzime të tjera. Rruga kryesore është rrethi, ndërsa hyrjet janë rrugët dytësor nëse janë të vendosur në to shenja” **Kryqëzim i rrugës me përparësi kalimi**”.

Këto kryqëzime mundësojnë rrjedhjen më të lehtë të trafikut, detyrimisht zvogëlohet shpejtësia e lëvizjes me çka rritet siguria rrugore, për arsye nuk ekziston kthimi majtas, ku zvogëlohen pikat e konfliktit. Trafiku zhvillohet në anën e kundërt të akrepave të orës.


Kryqëzimet me rreth-rrrotullim paralajmërohen me shenjen e trafikut **“Afërsia e kryqëzimit me rreth-rrrotullim”** si në çdo kryqëzim duhet të zvogëlohet shpejtësia e lëvizjes nëse është e nevojshme **dhe ti japë përparësi kalimi mjetet që lëvizin në rreth-rrrotullim përkatësisht në rrugën kryesore.**



Afërsia e kryqëzimit me rreth-rrrotullim

Kryqëzimi me rrethrrrotullim me një shirit të trafikut për një kah, nuk paraqet ndonjë vështirësi, se hyrja dhe të gjitha daljet bëhen vetëm nga një shirit i trafikut.

Në kryqëzim me rrethrrrotullim me dy shirita për një kah, shiriti i djathtë i skajshëm i trafikut përdoret për daljen e parë dhe të dytë, ndërsa shiriti i majtë përdoret për daljen e dytë, tretë dhe për ndryshimin e kahjes së lëvizjes.



Sinjalizimi i kryqëzimit me rreth-rrrotullim

Nëse rrethi i ka tre a më shumë shirita, ndërsa për dalje ekzistojnë dy shirita atëherë vlenë: nga shiriti i jashtëm në shiritin e djathtë (i djathti me të djathtin) dhe nga shiriti i brendshëm në shiritin e majtë (i majti me të majtin).



Kryqëzimi me rreth-rrotullim me shumë shirita trafikut

Në kryqëzim me rrethrrrotullim me tre apo më shumë shirita të trafikut si në hyrje, në rreth apo aq për dalje, nuk paraqet ndonjë vështërsi, duhet të respektohet sinjalizimi rrugor.



Nëse ekzistojnë dy shirita në rreth, ndërsa vetëm nga një dalje, atëherë kandidati për shoferë për cilin do dalje paraprakisht kalon në shiritin e jashtëm të rrethit siç shihet në figurë. P.sh kandidati për daljen e katërt pasi të kalon ndaljen e 3 kalon në shiritin e jashtëm të rrethit e pastaj bënë daljen nr.4. (shih figurën).

Kryqëzimi me rreth-rrotullim me një shirit në hyrje - dalje dhe me dy shirita në rreth

Nëse për hyrja në kryqëzim ekzistojnë dy shirita, ndërsa rrethi i ka tre shirita, ndërsa për dalje ekziston vetëm një shirit, kuptohet se dalja bëhet nga shiriti i jashtëm i rrethit siç është paraparë në figurën e sipërme. Nëse është e nevojshme duhet të sjellet në rreth-rrotullim, nëse kushtet dhe rrethanat nuk e lejojnë me kohë të kalojnë në shiritin e jashtëm të rrethit.

Kryqëzimi me nyje

Ngasja në kryqëzim me nyje nënkupton ngasjes në disnivele, ku trafiku zhvillohet pa ndërprerjen e fluskit të trafikut, në rrugët e nivelit të lartë p.sh në autostradë, motoudhë, etj.



Hyrja dhe dalja bëhet nëpërmjet shiritave përkatës siç shihet në foton e mësipërme p.sh kur autostrada “Arbër Xhaferi” kryqëzohet me autostradën “Ibrahim Rugava”.

Nyja në autostradë



Shiritin për ngadalësim i cili shërben për dalje (çkyçje) nga autostrada duhet ta shfrytëzoj kandidati për shoferë gjatë daljes nga autostrada.

Dalja nga autostrada

Teknika e ngasjes nëpër kryqëzim në disnivel

Kandidatit i sqarohet teknika e ngasjes në kryqëzim në disnivel, ku rrjedhja e trafikut zhvillohet pa ndërprerje dhe më shpejtësi më të madhe se sa në kryqëzimet që janë në të njëjtin nivel.

Ngasja bëhet sipas trajktores së lëvizjes së automjetit me ngjyrë të kaltër dhe të verdhë.



Ngasja në kryqëzim me disnivel

Kryqëzimi i rregulluar me polic



Kandidati për shoferë e drejton veturën e verdhë vazhdon lëvizjen edhe pse e ka dritën e kuqe në semafor pasi sipas pozitës së policit e ka kalimin e lirë.

Kryqëzim i rregulluar me polic

T7. NGASJA NË RRUGË TË RRAFSHËT, PËRBALLKALIMI, ANASHKALIMI, TEJKALIMI DUKE PËRFSHIRË NGASJEN NË HAPËSIRËN E KUFIZUAR

Ngasja në rrugë të rrafshët

Detyrat e instruktorit janë:

- jep instruksione për ngasje në rrugë të rrafshët dhe të drejtë;
- jep instruksione për humbjen e ndjenjës për shpejtësi dhe shoferin e nxit për shpejtësi të madhe;
- rritja e dëshirës për tejkalime;
- humbja e kontrollit mbi shpejtësinë e lëvizjes;
- mundësia e çuarjes në verbim nga dritat e automjeteve natën, gjatë përballkalimit
- ngasja në rrugë të gjatë e të drejtë është e rrezikshme, edhe pse fushëpamja e rrugës është e mirë.



Rruga e drejtë

Përballkalimi

Detyrat e instruktorit janë:

- Jep instruksione për ngasjen e automjetit gjatë përballkalimit;
- Jep instruksione për përshtatjen e shpejtësisë së automjetit gjatë përballkalimit;
- Jep instruksione për mbajtjen e distancës së siguriës anësore në mes mjeteve;
- Jep instruksione për përdorimin adekuat të pajisjeve ndriçuese gjatë përballkalimit (natën).

Në pjerrtësi gjatësore gjatë orës praktike jeni takuar me traktorin. Për ta mundësuar përballkalimin ju duhet të lëvizini prapa.



Përballkalimi

Teknika e ngasjes gjatë përballkalimit



Gjatë përballkalimit duhet pasur kujdes në distancën anësore të sigurisë e cila duhet të jetë e mjaftueshme për përballkalim të sigurtë.

Nëse automjetet që vijnë përball e kthehen majtas ato përballkalohen nga ana e djathtë e tyre.

Distanca e sigurisë anësore gjatë përballkalimit -ana e djathtë

Distanca anësore e sigurisë gjatë përballkalimit varet nga shpejtësia e lëvizjes dhe nga distanca anësore e automjetit dhe skajit të rrugës.



Përballkalim i rregulluar me shenja të trafikut

Kandidati për shofer ka përparsi kalimi ndaj vetures e cila vjen përballë, por nuk përjashtohet mundësia që vetura ta vazhdojë lëvizjen edhe pse nuk ka drejtë.



Kandidati për shofer duhet te ndalet dhe ti jap përparësi kalimi veturës e cila vjen përballë.

Përballkalimi i rregulluar me shenja trafikut

Tejkalimi dhe anashkalimi

Tejkalim - kalimi me mjet pranë mjetit tjetër rrugor që lëviz në të njëjtin kah.



Lejohet tejkalimi

Kandidati për shofer vështron trafikun nga prapa, sinjalizon me treguesin e majtë dhe kryen tejkalimin..



Nuk lejohet tejkalimi

Distanca anësore e sigurisë



Tejkalimi i biçiklistit

Në këtë situatë kandidati për shofer bënë tejkalimin (edhe pse është vija e plotë ndarëse) e biçiklistit dhe mban distancën anësore e sigurisë së paku **1 metër** si dhe gjatë gjithë kohës së kryrjes së veprimit sinjalizon me treguesin e drejtimit.

Rregullat e tejkalimit



Tejkalimi nga ana e djathtë

-Kandidati për shofer bënë tejkalimin e veturës nga ana e djathtë.



Tejkalimi bëhet nga ana e djathtë

- Kandidati për shofer bënë tejkalimin e tramvajit vetëm nga ana e djathtë.

Detyrimet e shoferit, mjete i të cilit tejkalohe



Tejkalimi bëhet nga ana e majtë

Kandidati për shofer është duke drejtuar veturën e bardhë
i cili tejkalohe:

- duhet ta largojë mjetin e tij kah skaji i djathtë i rrugës,
- nuk i lejohet ta rrisë shpejtësinë gjatë kohës gjersa tejkalohe.



Nuk lejohet tejkalimi - një shirit i trafikut në një kah

Kandidati për shofer para kthesë së rrezikshëm nuk i
lejohet tejkalimi në rrugë me një shirit trafiku për një kah.



Lejohet tejkalimi - dy shirita të trafikut në një kah

Kandidati për shofer para kthesë së rrezikshëm i
lejohet tejkalimi në rrugë me dy pse me tepër
shirita trafiku për një kah.




Lejohet tejkalimi i motokultivatorit

Kandidatit i lejohet tejkalimi i motokultivatorit edhe
pse është vija e plotë gjatësore



Kandidatit për shofer i lejohet tejkalimi në tunel në foto nëse nuk ka mjete nga prapa pasi që ekzistojnë dy shirita të trafikut në një kah.

Lejohet tejkalimi në këtë tunel



Kolona e automjeteve

Ndalohet tejkalimi i këtyre mjeteve (kolona)



Lejohet tejkalim

Lejohet tejkalimi i dy mjeteve në të njëjetn kohë



Lëvizja në rreshta paralele

Kandidatit i lejohet ndërrimi i shiritave vetëm për parakim apo dalje nga rruga qarkulluese.

Lëvizje në rreshta paralele

Anashkalimi



Kandidatit për shofer i lejohet anashkalimi edhe nga ana e djathtë dhe e majtë nëse nuk ka mjete nga prapa.

Anashkalim nga të dy anët

Ngasja në fushëpamje të kufizuar



Fushëpamje e kufizuar - hapësira e kufizuar të cilën pjesëmarrësi në trafik mund ta shohë nga vendi ku gjendet, për shkak të rrugës me kthesa të padukshme, me kurrize apo për shkak të ndonjë pengese fizike, të ndonjë objekti apo të ngjashme.

Fushëpamje e kufizuar



Fushëpamje e mirë e rrugës

Rruga me sinjalizim rrugor rrit sigurinë në trafikun rrugor.



Kthesë e rrezikshme majtas

Pjesët e rrugës me kthesa apo kurriz rruge paraqesin rrezik për shoferët e rinj, fillestarë dhe ata pa përvojë. Në kthesa mund të jetë pashmëria e kufizuar dhe ndikon forca centrifugale e cila tenton që ta largojë automjetin jashtë rrugës.

Distanca në mes të mjeteve

Distanca ndërmjet mjeteve gjatë ngasjes brenda vendbanimit duhet të jetë së paku 1 sekond.



Distanca e sigurisë

Distanca ndërmjet mjeteve gjatë ngasjes jashtë vendbanimit duhet të jetë së paku 2 sekond.



Distanca e sigurisë

Distanca ndërmjet mjeteve gjatë ngasjes në rrugë të rrëshqitshme duhet të jetë së paku 3 sekond.

T8. NDËRRIMI I KAHES SE LËVIZJES: KTHIMI DJATHTAS, MAJTAS RRESHTIMI NË SHIRITIN TJETËR TË TRAFIKUT

Detyrat e instruktorit:

- Jep instruksione mbi ndërrimin e kahjes së lëvizjes, kthimi djathtas, majtas, rreshtimi në shiritin tjetër të trafikut,
- Jep instruksione për shikimin në distancë të mjaftueshme përpara, për shikimin në pasqyrën e brendshme; në pasqyrat anësore të majtë dhe të djathtë si dhe për këndin e vdekur.
- Jep instruksione për rreshtimin me kohë për kthim djathtas, për kthim majtas dhe për sinjalizimin me kohë për veprimet e marra.

Teknika e ngasjes gjatë kthimi djathtas, majtas rreshtimi në shiritin tjetër të trafikut

Kandidati duhet të sqarohet se para çdo veprimi duhet shikuar së pari në pasqyre të brendshme, të jashtme, shikimi mbi supë (këndi i vdekur) dhe të sinjalizoj me tregues të drejtimit.

Teknika e ngasjes në kryqëzim, si bëhet rreshtimi, kthimi djathtas, majtas, kthimi gjysmërrethor dhe ngasja në kryqëzim është dhënë në vijim.

Kthimi djathtas dhe përzgjedhja e shiritit të trafikut

Kandidatit për shoferë i sqarohet si bëhet kthimi djathtas me automjet duke lëvizur nëpër shiritin e skajshëm të trafikut që shtrihet përgjatë skajit të djathtë të sipërfaqes së rrugës, përveç në qoftë se me shenjë të trafikut në rrugë nuk është caktuar ndryshe. Në rast të ndonjë pengesë statike apo mobile (automjeti i ndalur apo i parkuar, dëmtim i rrugës apo ndonjë pengesë tjetër) gjendet në shiritin e djathtë nga bëhet rreshtimi apo në rrugën anësore ku bëhet kthimi, atëherë mund të shfrytëzohet shiriti tjetër i trafikut, duke vështruar trafikun nga prapa (shikimin pasqyre të brendshme, jashtme, këndin e vdekur) dhe sinjalizohet me treguesin e drejtimit.





Lejohet kthimi djathtas pa u ndalur (semafori i gjelbërt, por me kujdes të shtuar këmbësorët mund të ndalen në rrugë dhe kombi i cili lëviz mund të ndalet pasi kthehet në rrugën anësore(ana e djathtë).



Kthimi djathtas

Kandidati për shofer (vetura e kaltërt) është rreshtuar me automjet për kthim djathtas, gjatë ngasjes në kryqëzim duhet të kujdeset për sigurinë dhe rrjedhjen e trafikut.

Kthimi djathtas nga një shirit i trafikut në rrugë me një shirit trafikut bëhet duke lëvizur sipas trajktores në këtë situatë.




Kthimi djathtas në kryqëzimin klasik



Kthimi djathtas në kryqëzimin T

Kthimi djathtas- kandidati i cili drejton veturën e gjelbërt kthehet djathtas me automjet pranë skajit të djathtë të rrugës në shiritin e djathtë të rrugës tërthore dhe duhet të sinjalizoj me treguesin e drejtimit.




Për kthim djathtas kandidati i cili drejton veturën e verdhë e shfrytëzon shiritin e djathtë të trafikut pranë skajit të rrugës një kahe, siç është paraqitur në këtë situatë.


Kthimi djathtas nga rruga një kahe në rrugë me dy kahe

Qëllimi i zgjedhjes së shiritit të trafikut ka të bëjë me rritjen e sigurisë dhe fluskit të trafikut.

Në këtë situatë kandidati është duke drejtuar veturën e gjelbër dhe bënë kthimin djathtas nga një shirit i trafikut në rrugë me tre shirita trafikut. Kandidatit i lejohet cilin do shirit të të kthehet me veturë dhe ta vazhdoj lëvizjen varsisht nga qëllimi i tij.



Kthimi djathtas nga një shirit i trafikut në rrugë me tre shirita trafikut



Në këtë situatë është paraqitur kthim djathtas nga shiriti i veçantë në rrugën tërthore me tre shirita, si dhe vetura e cila vjen nga kahu i kundërt e cila e bënë kthimin majtas. Kandidati për shoferë i cili e drejton veturën e gjelbër kthehet djathtas nga një shirit i trafikut në rrugë me tre shirita trafikut dhe mund të përzgjedhë cilin do shirit të trafikut në rrugën tërthore.

Kthimi djathtas nga një shirit i trafikut në rrugë me tre shirita trafikut dhe vetura e cila vjenë përballë

Nëse trafiku është rregullar me semafor (shih shigjetën e verdhë), atëherë gjatë kohës së ndezur së dritës së gjelbër, kandidatit për shoferë i tregohet se nga shiriti i djathtë i veçantë për kthim djathtas ka mundësi të kthehet në cilin do shirit të trafikut që dëshiron (shiritin e djathtë apo të majtin).



Kryqëzimi i rregulluar me semafor-shiriti i veçantë për kthim djathtas në rrugë me dy shirita të trafikut



Nëse trafiku është rregullar me semafor (shih shigjetën e verdhë), atëherë gjatë kohës së ndezur së dritës së gjelbër, kandidati për shoferë i tregohet nga shiriti i djathtë i veçantë për kthim djathtas ka mundësi të kthehet në cilin do shirit të trafikut që dëshiron (shiritin e djathtë, mesin apo të majtën). Njëjtë veprohet nëse ka më shumë shirita të trafikut.

Kryqëzimi i rregulluar me semafor-shiriti i veçantë për kthim djathtas në rrugë me tre shirita të trafikut

Gjatë ngasjes në kryqëzim kandidati për shoferë ti sqarohet se duhet të fokusohet në mjetet të cilat në atë moment gjenden në kryqëzim, në ato të cilat vijnë përball, dhe në ato të cilat lëvizin prapa ose pranë.

Për kthim djathtas janë të paraparë dy shirita si dhe dy shirita të trafikut për kthim majtas, si dhe në rrugën tërthor ekzistojnë dy shirita të trafikut.

Kthimet bëhen siç janë paraqitur në figurë i djathti me djathtin dhe i majti me të majtën.



Kthimet nga dy shirita në rrugë me dy shirita trafikut



Nga figura shihet se për kthim djathtas janë të paraparë dy shirita si dhe dy shirita të trafikut për kthim majtas, ndërsa në rrugën tërthore ekzistojnë tre shirita të trafikut. Shiriti i mesëm është i përbashkët për veturën e cila kthehet djathtas dhe asaj që kthehet majtas. Kandidati i cili drejton veturën me ngjyrë të gjelbër (e cila gjendet në shiritin e majtë) vazhdon kthimin djathtas para veturës së kuqe e cila ju vjen përballë.


Kthimet nga dy shirita në rrugë me dy shirita trafikut

Kthimi majtas dhe përzgjedhja e shiritit të trafikut

Kthimi majtas- kandidati për shoferë që e kthen veturën e kuqe majtas duhet ta bëjë kthimin nëpër shiritin e majtë të skajshëm të trafikut që shtrihet pranë vijës së mesit dhe nëpër harkun e paramenduar ose të shënuar që lidh dy (2) vijat e mesit të sipërfaqëve anësore të rrugës, përveç në qoftë se me shenjë të trafikut në rrugë nuk është caktuar ndryshe.

Kthimi majtas nga një shirit i trafikut në rrugën me një shirit trafiku

Kandidati që e kthen veturën e verdhë majtas duhet ta bëjë nëpër shiritin e trafikut që shtrihet përgjatë skajit të majtë të rrugës në trafik me rrugë me një kah, përveç në qoftë se me shenjë të trafikut në rrugë nuk është caktuar ndryshe.


***Kthimi majtas nga rruga një kahe***

Nëse ekziston shiriti i veçantë për kthimi majtas si në këtë situatë, me qëllim të rrjedhes së trafikut sa më shpejtë dhe mos të vijë deri te ngecja në trafik, i lejohej kandidatit për shofer i cili drejton veturën e kuqe të bëjë kthimin majtas në cilin do shirit të rrugës tërthore.

Kthimi në kryqëzim majtas nga një shirit i trafikut në rrugë me dy shirita trafiku

Në këtë situatë është paraqitur kthim majtas nga shiriti i veçantë në rrugën tërthore me tre shirita të trafikut. Kandidati i cili drejton veturën e kaltër mund të kthehet majtas në cilin do shirit të rrugës tërthore dhe ta vazhdojë lëvizjen varsisht nga qëllimi i tij.

***Kthimi majtas nga shiriti i veçantë në rrugë me tre shirita trafik***



Në këtë situatë është paraqitur kthim majtas nga shiriti i veçantë në rrugën tërthore me tre shirita, si dhe vetura e cila vjen nga kahu i kundër dhe e bënë kthimin djathtas.


Kthimi majtas nga shiriti i veçantë në rrugë me tre shirita trafikut me veturën e cila vjen nga kahu i kundërt

Kandidati i cili drejton veturën e cila gjendet në shiritin e majtë të skajshëm i lejohet kthimi vetëm në shiritin e majtë të skajshëm në rrugën tërthore. Vetura e cila është rreshtuar në shiritin e djathtë i lejohet ta bëjë kthimin majtas në shiritin e mesëm apo në shiritin e djathtë të skajshëm në rrugën tërthore (shih fig.).



Kthimi majtas nga dy shita të trafikut në rrugë me tre shirita trafikut

Kthimi majtas prej dy shiritave trafikut




Kthimi majtas nga dy shirita në rrugë me tre shirita

Në këtë situatë kthim majtas bëhen nga shiriti i trafikut që shtrihet në afërsi të mesit të rrugës në rrugën tërthore me dy shirita të trafikut. Me qëllim të rrjedhjes së trafikut sa më shpejtë automjetet lëvizin sipas rradhitjes siç është paraqitur në këtë figurë.



Kthimi majtas nga shiriti i veçant në rrugë me dy shirita


Teknika e ngasjes nëpër kryqëzim të formës ‘T’ është paraqitur në figurën vijuese.



Kandidati i cili drejton veturën e kuqe që kthehet majtas në rrugën tërthore ku trafiku zhvillohet në një kahe, kthimi bëhet siç është paraqitur në këtë situatë.

Kthimi majtas nga rruga dy kahe në rrugën një kahe

Kandidati për shoferë i cili drejton veturën e kaltërt mund të bëjë kthimin majtas në të njëjtën kohë me shoferin i cili e drejton veturën e gjelbër, pasi nuk ka pika konfliktouze. Shoferi i cili drejton veturën e kuqe kthimin duhet të bëjë pasi të kalojë vetura e gjelbër, në shiritin e djathtë në rrugën tërthore ku trafiku zhvillohet në një kahe.




Kthimi majtas nga dy shirita të trafikut në rrugë me dy shirita trafikut (rruga një kahe)



Kandidati për shoferi për kthim majtas e bënë kthimin nëpër shiritin e majtë të skajshëm të trafikut dhe sinjalizon me tregues të drejtimit. Mund ta bëjë edhe kthimin gjysmërrethor.

Kthimi majtas nga shiriti i veçantë



Kandidat për shofer është rreshtuar drejtë për kthim majtas në rrugë një kah dhe duhet të sinjalizoj me tregues e drejtimit

Rreshtimi për kthim majtas nga rruga ku trafiku zhvillohet në një kahe



Ndalohet kthimi majtas dhe kandidati për shofer duhet të respektoj shenjën e trafikut “STOP” dhe ta ndalë automjetin para vijës së plotë ndalëse. Nëse në kryqëzim nuk ekziston vija e plotë tërthore ndalëse, kandidati ndalet para vijës së pamurit.

Ndalohet kthimi majtas

Kthimi gjysmërrethor

Detyrat e instruktorit:

- Jep instruksione për përshtatjen e shpejtësisë;
- Jep instruksione për rreshtimin me kohë në shiritin përkatës;
- Jep instruksione për sinjalizimin me kohë me treguesit e drejtimit

Teknika e ngasjes gjatë kthimi gjysëm rrethor

Instruktor shoferi gjatë ushtrimit të kthimit gjysmërrethor duhet të ketë kujdes në zgjedhjen e vendit në rrugë apo në kryqëzim duke i pasur për bazë elementet kohore dhe hapsinore si dhe dendësin e trafikut. Nuk rekomandohet të ushtrohet ky veprim në pjesën e rrugës apo në kryqëzim ku dendësia e trafikut është e madhe e që paraqet pengesë ose rrezikim të trafikut rrugor.

Për të bërë kthimin e gjysmërrethor, lejohet përdorimi i bankinës, vendparkimet, apo ndonjë sipërfaqe tjetër jashtë rrugë publike nëse nuk pengohen dhe rrezikohen pjesëmarrësit tjerë.

Teknika e ngasjes gjatë kthimit gjysmërrethor është paraqitur në fig. vijuese:

-pa manovrim.



Kandidati këtë veprim e fillon pas vështërimit të trafikut nga prapa (pasqyre e brendshme, e jashtme, shikimi mbi supe-këndi i vdekur) përpara dhe pasi të bindet se nuk i pengon ose i rrezikon pjesëmarrësit tjerë, duke sinjalizuar me treguesit e drejtimit ja fillon veprimin.

Kthimi gjysmërrethor pa manovrim në rrugë publike

-pa manovrim duke shfrytëzuar hapsirën në kryqëzim

Në kryqëzim kërkohet që kandidati sa ma shpejtë që e mundshme duke pasur parasysh distancën, hapsirën dhe kohën në dispozicion të bëjë kthimin gjysmërrethor që nënkupton se të shfrytëzohet distanca sa më e shkurtë dhe koha e kryrjes së veprimit të jetë sa më e shkurtë (*shih trajktorja nr.1*), duke mos i penguar apo rrezikuar pjesëmarrësit tjerë në trafik, për ndryshe nuk i lejohet të fillohet një veprim i till. Nëse gjeometria e kryqëzimit dhe elementet teknike të automjetit nuk mundësojnë një veprim të tillë, mund të shfrytëzohet trajektorja e lëvizjes nr.2.



Kthimi gjysmërrethor pa manovrim në kryqëzim


Lejohet kthimi gjysmërrethor duke shfrytëzuar rrugët anësore në anën e djathtë dhe të majtë duke lëvizur mbi vendkalimin e këmbësorëve, nëse nuk pengohen ose nuk rrezikohet siguria e tyre.

Nëse gjatë kthimit gjysmërrethor vjen deri te një situatë e papritur të rrezikshme, atëherë kandidati për shofer duhet të vazhdojë lëvizjen majtas përkatësisht djathtas, ose nëse nuk ka filluar ende kthimin gjysmërrethor të heq dorë nga ky veprimi në fjalë.

Kthimi gjysmërrethor ndalohet me sinjalizim rrugor (shenja e trafikut e ndalimit, drejtimi i obliguar drejtë, vijë e plotë gjatësore, etj) dhe me rregullat e trafikut dhe sigurisë (në autostradë, tunel, etj).

- duke shfrytëzuar rrugën dytësore (anësore) të kryqëzimit

Instrukcionet për kandidatin për shoferi i cili e bënë kthimi gjysmërrethor duke shfrytëzuar rrugën anësore janë si vijon:




-e kalon kryqëzimin deri kah mesi e ndezë treguesin e djathtë të drejtimit pasi ta kaloj kryqëzimin vijën tërthore për afërsisht një gjatësi të veturës, ndalet i ndezë të gjithë treguesit e drejtimit dhe me lëvizje prapa hynë në rrugën anësore deri te vija ndalëse e plotë apo e ndërprerë dhe ndalet duke sinjalizuar me treguesin e majtë të drejtimit dhe e bënë kthimin gjysmë rrethor,

-pastaj i ndezë të gjithë treguesit e drejtimit dhe me lëvizje prapa hynë në rrugën anësore deri te vija ndalëse nëse nuk ekziston deri te vija e pamurit. Pastaj sinjalizojmë me treguesin e drejtimit dhe e bëjmë kthimin gjysmë rrethor me kujdes të shtuar, nëse ka vijë të plotë gjatësore nuk lejohet të shkelim apo të kalojmë mbi te.

Kthimi gjysmërrethor duke shfrytëzuar rrugën anësore të kryqëzimit në rrugën dytësore

Nuk lejohet kthimi gjysmërrethor nëse gjatë ngasjes prapa lëvizet mbi vendkalimin e këmbësorëve, biçiklistëve, etj, apo të hyjë me ngasje prapa në rrugën me përparësi kalimi apo të hyjë me ngasje prapa nga ndonjë sipërfaqe jashtë rrugës publike apo të ngajshme në rrugën qarkulluese. Në këto vende dhe në këto rrethana nuk lejohet të ushtrohet veprimi i kthimit gjysmërrethor dhe nuk ka asnjë përjashtim (p.sh. instruktori të bëjë sigurimin gjatë ngasjes prapa).

- në kryqëzim




Kandidatit për shofer i lejohet kthimi gjysmërrethor nga shiriti i majtë i skajshëm, rekomandohet nëse ka mundësi teknike në shiritin e tretë për shkaqe sigurie (varsisht nga karakteristikat teknike të automjetit, gjeometrisë të kryqëzimit, gjerësive të shiritave të trafikut), por mundet të bënë kthimin gjysmërrethor edhe në shiritin e dytë apo të parin. Gjatë gjithë kohës duhet pasur në vëzhgim situatën në trafik duke mos i penguar apo rrezikuar pjesëmarrësit tjerë në trafik.

Kthimi gjysmërrethor në kryqëzim

Pavarësisht cilin shirit e bënë kthimin gjysmërrethor i lejohet kandidatit pastaj nëse dëshiron të bëjë ndërrimin e shiritit (nëse vija gjatësore është e ndërprerë) nëse nuk pengohet trafiku nga prapa dhe duke sinjalizuar me tregues të drejtimit.

Në kryqëzim kur lejohet kthimi mjetas, kandidati për shoferë mund të bëjë kthimin gjysmërrethor nëse me shenjë të trafikut nuk e ka të ndaluar.



Nuk lejohet kthimi gjysmërrethor

Kandidatit për shofer i lejohet vetëm kthimi mjetas dhe duhet të sinjalizoj me treguesin e majtë të drejtimit.

Gjatë aftësimit të kandidatëve për mjetet e gjata dhe bashkësive të mjeteve nuk zbatohen rregullat për kthime, nëse lejohen kushtet të shfrytëzohen sipërfaqet jashtë rrugës publike për kthimet e lartë cekura.


Teknika gjatë ndërrimit të shiritave të trafikut

Për kthimin mjetas i lejohet ndërrimi i shiritit nëse është vija e ndërprerë gjatësore (shih shigjeten).



Lejohet ndërrimi i shiritit për kthim mjetas

Kandidatit për shofer i lejohet ndërrimi i shiritit të trafikut, duke vështuar trafikun nga prapa (pasqyret, këndin e vdekur) dhe sinjalizuar me tregues të drejtimit.




Nëse kandidati e drejton veturën e kuqe në këtë situatë, atëherë duhet të zvogëlohet shpejtësia sipas nevojës dhe t'ia mundësoj veturës së gjelbër të pari ndërrimin e shiritit të trafikut (vlenë rregulla e krahut të djathtë), pastaj të kaloj në shiritin e djathtë.

Ndërrimi i shiritave të trafikut

Instruktori duhet të jep me kohë instruksionet për ndërrim të shiritave, duke pasur parasysh distancën dhe kohën në dispozicion që veprimi të bëhet në mënyrë të drejtë sipas rregullave të trafikut dhe sigurisë.


Nëse gjatë aftësimit praktik, kandidati për shoferë duke drejtuar veturën në rrugë me tre shirita trafikut për një kah, nuk i lejohej të ndërroj dy shirita për njëherë. Kandidati për shoferë së pari duhet të kaloj në shiritin e mesëm nr.2 (paraparkisht është siguruar se në shiritin e mesëm nuk ka mjete që lëvizin prapa), pas ti kaloj në shiritin e mesëm dhe merr pozitën në këtë shirit, pastaj përsëri shikon në pasqyre të brendshme të jashtme,



këndin e vdekur, nëse nuk ka asnjë mjet prapa sinjalizon pastaj kalon në shiritin e majtë të skajshëm nr.3 dhe vazhdon lëvizje. Nëse rruga ka katër e më shumë shirita të trafikut vlejnë të nëjta rregulla siç janë përshkruar më sipërme. Kjo rregull nuk zbatohet gjatë hyrjes në kryqëzimi me rreth-rotullim apo në kryqëzim me semafor me tre apo më shumë shirita, kur ekziston shiriti i veçantë për kthim djathtas.

Ndërrimi i shiritave të trafikut

Teknika gjatë ngasjes prapa



Kandidati i sqarohet për veprimet që duhet të ndërmmiren gjatë ngasjes prapa, masat e sigurisë, sinjalzimi me të gjithë treguest e drejtimit.

Lëvizja prapa

T9. HYRJA NË AUTO UDHË OSE NË RRUGË TE NGJASHME (NËSE EKZISTOJNË) DHE DALJA NGA TO, HYRJA NË TRAFIK NË SHIRITIN PËR NXITIM, DALJA NGA RRJEDHA E TRAFIKUT NGA SHIRITI PËR NGADALËSIM

Hyrja dhe dalja në rrugët me intensitet të madh në trafik

Detyrat e instruktorit gjatë hyjes në rrugë me intensitet të lartë trafikut:

- jep udhëzime kandidatit për perceptimin e shenjave të trafikut;
- jep udhëzime kandidatit për përshtatjen e shpejtësisë dhe sinjalizimin me kohë;
- jep udhëzime kandidatit për shfrytëzimin e shiritit për nxitim gjatë hyjes në autoudhë

Detyrat e instruktorit gjatë ngasjes në autostradë janë:

- Jep udhëzime kandidatit për ngasjen në shiritin e djathtë të skajshëm nëse është i lirë.
- Jep udhëzime kandidatit për ngasjen duke respektuar limitin maksimal dhe minimal të shpejtësisë.
- Jep udhëzime kandidatit për rritjen e distancës së sigurisë.
- Jep udhëzime kandidatit për kontrollimin e trafikut kohë pas kohe nga prapa (pasqyre).
- Jep udhëzime kandidatit për përdorimin e pajisjeve sinjalizuese gjatë veprimeve në trafik; tejkalimi, rreshtimi etj;
- Jep udhëzime kandidatit për ndaljen e automjetit në shiritin për ndalje emergjente në autoudhë.

Detyrat e instruktorit gjatë daljes nga autostrada janë:

- Jep udhëzime kandidatit për perceptimin e shenjave të trafikut për dalje nga autoudha;
- Jep udhëzime kandidatit për përshtatjen e shpejtësisë dhe sinjalizimin me kohë për dalje nga autoudha;.
- Jep udhëzime kandidatit për shfrytëzimin e shiritit për ngadalësim gjatë daljes nga autoudha.

Teknika e ngasjes gjatë hyjes në autostradë

Instruktori i sqaron kandidatit tekniken e hyjes me automjet në autostradë:

- të shfrytëzojë shiritin për nxitim, kur ai shirit ekziston, duke dhënë shenjë përkatëse me tregues të drejtimit dhe duke hyrë në rrjedhën e trafikut në atë mënyrë që të mos e rrezikojë trafikun e automjeteve që lëvizin nëpër autoudhë;

- t'i japë përparësi kalimi automjetit tjetër i cili lëviz nëpër autoudhë, nëse nuk ekziston shirit i posaçëm për nxitim.
- Hyrja në autostradë duhet të bëhet në mbarim të shiritit për nxitim duke rritur shpejtësin duke mos i penguar automjetet që janë duke lëvizur në autostradë.



Shirit për hyrje në autostradë

Për dalje nga autostrada duhet ta shfrytëzoni shiritin për ngadalësim dhe te sinjalizoni me tregues të drejtimit.




Shiriti për dalje (ngadalësim) nga autostrada

Teknika e ngasjes gjatë shfrytëzimit të shiritit për nxitim dhe ngadalësim në autostradë

Teknika e ngasjes gjatë shfrytëzimit të shiritit për nxitim është dhënë në vijim:

- *Duhet siguruar se nuk pengohen dhe rrezikohen automjetet të cilat lëvizin në rrugën në të cilin hynë,*
- *Vështrohet trafiku,*
- *Sinjalizohet me treguesin e drejtimit,*


- Nuk lejohet hyrja në fillim të shiritit për nxitim,
- Rritet shpejtësia e lëvizjes,
- Hyrja në rrugë bëhet në përfundim të shiriti për nxitim.



Shiriti për nxitim

Teknika e ngasjes gjatë shfrytëzimit të shiriti për ngadalësim në autostradë është dhënë në vijim:

- Duhet siguruar se nuk pengohen dhe rrezikohen automjetet të cilat lëvizin nga prapa,
- Vështrohet trafiku,
- Sinjalizohet me treguesin e drejtimit,
- Nuk lejohet frenimi në shiritin e trafikut,
- Kalohet në fillim të shiritit për ngadalësim,
- Kontrollohet shpejtësia e sipas nevojës ngadalësohet automjeti,
- Nuk lejohet dalja në përfundim të shiriti për ngadalësim.



Shiriti për ngadalësim



Trafiku në autoudhë

Kandidati i sqarohet se në autostradë, automjetet duhet të lëvizin në shiritin e djathtë të skajshëm të trafikut i cili nuk është i zënë me automjete që lëvizin në kolonë.

Kandidatit i sqarohet se në autostradë ndalohet:



Ndalohet kthimi gjysmërrethor

- **kthimi gjysmërrethor,**
- **lëvizja mbrapa**

Ngasja në motoudhë - rrugët nacionale me dy shirita trafiku për një kahe si dhe hyrja/dalja në këto rrugë

Detyrat e instruktorit janë:

- Jep udhëzime kandidatit për përceptimin e shenjave të trafikut në rrugët nacionale.
- Jep udhëzime kandidatit për përshtatjen e shpejtësisë dhe sinjalizimi me kohë në rrugët nacionale;
- Jep udhëzime kandidatit për zgjedhjen e momentit të duhur për hyrje në rrugë nacionale.
- Jep udhëzime kandidatit për përshtatjen e shpejtësisë për përcjelljen e trafikut nga prapa (pasqyre) në rrugët nacionale.
- Jep udhëzime kandidatit për shfrytëzimin e shiritit të skajshëm gjatë daljes nga rruga nacionale.

Teknika e ngasjes gjatë hyrjes, ngasjes dhe daljes nga motoudha dhe në rrugët nacionale me dy shirita për një kahe

Në parim motoudha dhe rruga nacionale nuk kanë shirit për nxitim andaj duhet ti sqarohet kandidatit për rreziqet e mundëshme gjatë hyrjes në këto rrugë, paraprakisht vlerësohet trafiku në këto rrugë. Ndërsa gjatë ngasjes në këto rrugë duhet t'i përmbahen kufizimeve që vlejné për këto rrugë dhe hyrjet dhe daljet të bëhen me kujdes të shtuar pasi nuk kanë shiritat përkatës për hyrje dhe për dalje. Te rrugët nacionale kryqëzimet janë në të njëjtën nivel gjë që mund të rrezikohet siguria në trafikun rrugor për shkak mos respektimit të përparësisë kalimit në kryqëzime. Është me rëndësi që të vlerësohet saktë largësia e automjeteve të cilat lëvizën në rrugë nacionale gjatë hyrjes në rrugën nacionale, ashtu që të mos pengohen dhe rrezikohet mjetet të cilat lëvizn në rrugën nacioanle. Nëse rrugët nacionale dhe motoudha kanë shiritin për hyrje (nxitim) apo dalje (ngadalsim), teknika e ngasjes në këta dy shirita është e njëjtë sikur është në autostradë përshkruar më lartë.



Rrugë Nacionale me një shirit për një kahe

- Gjatë aftësimit praktik në rrugë nacionale me një shirit të trafikut për një kah, i lejohe ngasja me shpejtësi deri **80 km/h** (shih foton), ndërsa në rrugë nacionale me dy shirita për një kahe shpejtësia maksimale është **100 km/h** (nëse me shenjë nuk është përcaktuar ndrsyhe).

T10. KARAKTERISTIKAT E VEÇANTA TE RRUGËS: KRYQËZIMI ME RRETH RROTULLIM; VENDKALIMI HEKURUDHOR, VENDNDALJE TRAMVAJIT \ AUTOBUSËVE; VENDKALIMIN E KËMBËSOREVE; NGASJA NE PJERRËSI GJATËSORË PËRPJETËZE\ TEPOSHTËZE

a) Kryqëzimi me rrethrrrotullim



Detyrat e instruktorit janë:

- Jep udhëzime kandidatit për përcëptimin e shenjave të trafikut në rrethrrrotullim;
- Jep udhëzime kandidatit për përshtatjen e shpejtësisë sipas nevojës reduktimi i saj para kryqëzimit në rrethrrrotullim;
- Jep udhëzime kandidatit për respektimin e përparësisë së kalimit në rrethrrrotullim;
- Jep udhëzime kandidatit për rreshtimin me kohë në shiritin adekuat për hyrje - dalje më të lehtë nga rrethrrrotullimi.
- Jep udhëzime kandidatit për përdorimin e shiritave sipas destinimit në rrethrrrotullim.
- Jep udhëzime kandidatit për sinjalizimin me kohë gjatë daljes nga rrethrrrotullimi.

Teknika e ngasjes në kryqëzim me rrethrrrotullim është sqaruar më lartë.

b) Vendkalimi hekurudhor



Detyrat e instruktorit janë:

- Jep udhëzime kandidatit për përcëptimin e shenjave të trafikut para vendkalimit hekurudhor;
- Jep udhëzime kandidatit për përshtatjen e shpejtësisë sipas nevojës zvogëlimi i saj para vendkalimit hekurudhor;
- Jep udhëzime kandidatit për ndaljen e mjetit para pajisjeve ndriçuese, mbrojtëseve ose gjysmë mbrojtëseve, kur janë të aktivizuara;
- Jep udhëzime kandidatit për ndaljen e mjetit para shenjës STOP dhe ndalja para vendkalimit hekurudhor kur personi i autorizuar e ndalon kalimin nëpër të;
- Jep udhëzime kandidatit për fikjen e motorit gjatë pritjeve të gjata.

Teknika e ngasjes në vendkalimin hekurudhor

Kandidatit duhet sqaruar se pasi hasim në shenjen e trafikut “Afërsia e vendkalimit hekurudhor me ose pa mbrojtëse” varësisht nga rregullimi i trafikut përshtatet shpejtësia e lëvizjes. Nuk lejohet hyrja në vendkalimin hekurudhor të pasiguruar, para se paraprakisht të bindem se nuk është treni në ardhje. Nëse trafiku në vendkalim hekurudhor është i rregulluar me shenja të trafikut si në foton vijuese, kandidati për shoferë duhet të ndalet para shenjës STOP, dhe të shikoj dy anët e rrugës pastaj vazhdon lëvizjen me kujdes të shtuar.

Shenja e trafikut “ Kryqi i Andreut” tregon kalimin e rrugës përtej hekurudhës me një palë binar.



Shenja e trafikut “ Kryqi i Andreut”

Kandidatit i ndalohet:

- të kalojë anash mbrojtëseve apo gjysmëmbrojtëseve dhe të hyjë në vendkalim hekurudhor nën rrethanat kur ulja e mbrojtëseve apo gjysmëmbrojtëseve ka filluar, ose kur ngritja e tyre nuk ka përfunduar,



Vendkalim hekurudhor me mbrojtëse ose gjysëm mbrojtëse(i siguruar)

- të hyjë në vendkalim hekurudhor nëse janë të ndezura sinjalet, dritat ose pajisjet akustike me të cilat paralajmërohet ardhja e mjetit në binarë.

Teknika e ngasjes në vendndalje të autobusëve



Instruktionet e instruktorit për “Vendndalje të autobuësve” janë:

- Jep udhëzime kandidatit për përceptimin e shenjave të trafikut për vend ndalje të autobusëve /tramvajit.
- Jep udhëzime kandidatit për përshtatjen e shpejtësisë sipas nevojës zvogëlimi i saj para vend ndaljes së autobusëve /tramvajit.
- Jep udhëzime kandidatit për ndaljen e automjetit prapa autobusit gjatë hyrjes së tij në trafik (brenda zonës urbane).
- Jep udhëzime kandidatit për ndaljen e mjetit para / mbrapa mjetit të autobusit shkollor (rrugë me dy shirita të trafikut).
- Jep udhëzime kandidatit për ndaljen e mjetit gjatë kalimit të udhëtarëve nëpër shiritin e trafikut

Sjellja ndaj mjeteve të transportit publik

Instruktionet për kandidatin për shoferë në situatat vijuese janë:

- duhet të lëvizë me shpejtësi të zvogëluar dhe me kujdes të shtuar, ashtu që të mos i rrezikojë personat të cilët hyjnë ose dalin nga mjeti.



Vendndalimi i autobusit të shkollës

Autobusi i ndalur në vendndalje

Kandidati për shoferë i cili është duke drejtuar veturën duhet të ndalet prapa autobusit deri sa hyjnë apo dalin fëmijët/nxënsët nga autobusi i tyre.



Transporti i organizuar për fëmijë/ nxënës

Autobusi i cili transporton fëmijë/nxënës



Vendndalimi i autobusëve

Në këtë situatë kandidati për shoferë duhet të mundësoj hyrjen e autobusit në shiritin e trafikut dhe të jetë i kujdesshëm për personat që mund të dalin në rrugë. Njëjët vepron edhe nëse është në pyetje autobusi i cili bartë fëmijë/nxënsat në mënyrë të organizuar

Hyrja e autobusit në trafik

Vendkalimi i këmbësorëve

Detyrat e instruktorit janë:


- Jep udhëzime kandidatit për planifikimin paraprak, përceptimin e shenjave të trafikut të këmbësorëve;
- Jep udhëzime kandidatit për përshtatjen e shpejtësisë sipas nevojës zvogëlimit i sajë në afërsit të vendkalimit të këmbësorëve;
- Jep udhëzime kandidatit për përceptimin e situatës së rrezikshme në vendkalim të këmbësorëve;
- Jep udhëzime kandidatit ndaljen e automjetit para vendkalimit të këmbësorëve gjatë kalimit të këmbësorëve;
- Jep udhëzime kandidatit ndaljen e automjetit para vendkalimit të këmbësorëve kur e ka të ndaluar kalimin me sinjalizim rrugor apo me shenjë policit;
- Jep udhëzime kandidatit mosndaljen e mjetit mbi vendkalim të këmbësorit.

Sjellja ndaj këmbësorëve

Kandidati për shoferë gjatë ngasjes, jepen instruksionet se nuk duhet ti rrezikoj këmbësorët të cilët janë duke hyrë në rrugën qarkulluese (njërën këmbë e ka në rrugën qarkulluese), apo janë duke lëvizur apo duke qëndruar në rrugën qarkulluese jashtë vendkalimit të këmbësorëve.

Kandidati për shoferë jepen instruksionet se duhet ti japim përparësi kalimi këmbësorëve në vendkalimin e tyre, apo gjatë kthimit me mjet në rrugën anësore edhe nëse nuk ekziston vendkalimi i shënuar për këmbësorë. Pastaj kandidati për shofer gjatë ngasjes, duhet të ketë kujdes të shtuar gjatë kalimit të rrugës nga pjesëmarrësit më rrezikuarit në trafikun rrugor (personat me aftësi të kufizuar, verbërve, moshuar dhe fëmijëve) dhe të njëtit duhet ti japë përparësi kalimi.

Kandidati për shoferë jepen instruksionet se duhet të ndalet me mjet deri sa këmbësori ta kaloj rrugën qarkulluese, nëse rruga është me ndarje fizike deri sa të kalon në ishullin e këmbësorëve, përkatësisht ndarjen fizike të rrugës. Në qoftëse se rruga qarkulluese i ka nga dy shirita të trafikut për secilin kahe pa ndarje fizike, kandidati për shofer duhet të ndalet me automjet e të qendroj deri sa largohet këmbësori së paku një shirit të trafikut, ashtu që nëse kthehet këmbësori prapa të mos rrezikohet. Kandidati për shoferë gjatë ngasjes, jepen instruksionet se duhet të jetë i kujdesshëm ndaj këmbësorëve të cilat gjinden në afërsi të vendkalimit të shënuar për këmbësor dhe ndërrmer masat për ti mos penguar dhe rrezikuar ata nëse tentojnë të kalojnë rrugën.

Teknika e ngasjes në vendkalimin të këmbësorëve

Duke pasur parasysh se në vendkalim të këmbësorëve kalojnë këmbësorët duhet pasur kujdes të shtuar duke lëvizur me shpejtësi të zvogëluar dhe sipas nevojës të ndalim para vendkalimit për ti dhënë përparësi kalimi. Çdo herë duhet të shikohet në dy anët se mos po tenton apo është duke e kaluar ndonjë këmbësor rrugën.

Sipas nevojës, do të zvogëloj shpejtësinë dhe do të të jem i gatshëm për frenim

Vendkalimi për këmbësorë

Bllokimi i vendkalimeve

Kandidatit i sqarohet se nuk i lejohet të ndalet në vendkalim të shënuar për këmbësorë, biçiklistë, hekurudha, etj, nëse trafiku është i dendur paraprkisht duhet të planifikojë ngasjen, se ka hapësirë të mjaftueshme prapa vendkalimit të tillë, nëse trafiku është bllokuar.



Ndalja e veturës jo në rregull

Vetura nuk ka drejtë të ndalet në vendkalim të këmbësorëve, duke penguar lëvizjen e këmbësorëve.



Kthimi majtas në rrugën anësore ku nuk ka vendkalim të këmbësorëve

Kandidati për shoferë duhet mi jepë përparësi kalimi këmbësorit i cili është duke kaluar rrugën anësore.

Kujdesi ndaj pjesëmarrësve të veçantë

Në rastin kur rruga kalohet nga persona me aftësi të kufizuara, nga persona të moshuar, nga personat e verbër, ose nga fëmijët, shoferi detyrohet ta ndalë mjetin, në mënyrë që t'ua mundësojë atyre personave që ta kalojnë rrugën.



Personi i moshuar duke kaluar rrugën

Instruktionet për kandidatin janë: **duhet të lëshoj personin e moshuar i cili mban shkopinë, frenojm dhe ndalim veturën.**



Në këtë situatë kandidati duhet të frenoj dhe të ndal veturën, instruktori duhet të ketë nën kontroll situatën e trafikut

Personi i verbër duke kaluar rrugën



Në shumicën e rasteve këmbësorët nuk shikojnë dy anët e rrugës duke rrezikuar vetën dhe shoferin e automjetit. Prandaj, kandidati gjithënjë në rast nevojë duhet të jetë i përgatitur të reagojë, pasi që veprimet e fëmijëve janë të paparashikueshme.

Mosvështrimi i trafikut nga ana e fëmijës

Instruksionet për kandidatin janë: duhet ta largojë këmbën nga pedalja e gasit (të mos i jep gaz dhe në rast nevojë të jetë i gatshëm për frenim), nëse këmbësori hyn në rrugë.




Fëmijët mund të vrapojnë pas topit

Nëse topi rrokulliset para automjetit, Instruksionet për kandidatin janë:

- duhet ta zvogëlojë shpejtësinë dhe të jetë i gatshëm për frenim, pasi që fëmijët mund të vrapojnë pas topit.

Vendkalimi i biçikletave



Instruktionet për kandidatin janë:

- i jep përparësi kalimi biçiklistit,
- e zvogëlon shpejtësinë sipas nevojës,
- pastaj lëviz para veturës së kaltër.

Biçiklisti ka përparësi kalimi



Instruktionet për kandidatin janë:

- i jep përparësi kalimi biçiklistit i cili lëviz në shtegun e biçikletave,
- zvogëlohet shpejtësia sipas nevojës ndalim automjetin.

Biçiklisti ka përparësi kalimi




Në këtë situatë fëmija mund të veprojë spontanisht pa parashkim duke hyrë në rrugën qarkulluese, pa e vërejtur automjetin.

Kandidatit i jepen instrukcionet që ta largoj këmbën nga pedalja e gazit (të mos i jep gaz dhe të jet i gatshëm në rast nevojë për frenim) dhe vëzhgoni sjelljen e biçiklistit.

Mosvështrimi i trafikut nga ana e fëmijës-biçiklistit

InstrukSIONET PËR KANDIDATIN NË KËTË SITUATË JANË:

- sinjalizojna me treguesit e drejtimit;
- vazhdojna me kujdes të shtuar djathtas;
- japim përparësi kalimi këmbësorëve që janë duke lëvizur në rrugën anësore.



Ngasja ne pjerrësi gjatësorë përpjetëze \ teposhtëze.

Detyrat e instruktorit janë:

- Përzgjedh lokacionin për ta demonstruar kandidati veprimin;
- Jep udhëzime kandidatit për perceptimin e shenjave të trafikut që kanë të bëjnë me pjerrtësi gjatësore – përpjetëve;
- Jep udhëzime kandidatit për përshtatjen e shkallës së transmisionit sipas pjerrtësisë së rrugës;
- Jep udhëzime kandidatit për shikimin në tabelën instrumentale për të kontrolluar punën e motorit;
- Jep udhëzime kandidatit për ndaljen dhe nisjen në përpjetëze me lëvizje para dhe mbrapa duke përdorur frenin e dorës (ndihmës);
- Jep udhëzime kandidatit për sigurimin e automjetit të ndalur nga vetëlëvizja;
- Jep udhëzime kandidatit për lëshimin e friksionit ngadalë dhe njëjtën kohë duke dhënë gas gradualisht.

Ngasja teposhtëze

Detyrat e instruktorit janë:

- Jep udhëzime kandidatit për perceptimin e shenjës së trafikut për ngasje në teposhtëze.
- Jep udhëzime kandidatit për rritjen e distancës së sigurisë për ngasje në teposhtëze.
- Jep udhëzime kandidatit për ndërrimin e shkallës së transmisionit me kohë.
- Jep udhëzime kandidatit për frenimin me pedale të këmbës sipas nevojës;
- Jep udhëzime kandidatit për sigurimin e automjetit të ndalur nga vetëlëvizja.

- Jep udhëzime kandidatit për ndaljen dhe nisjen në teposhtëze duke përdorur frenin e dorës për lëvizje përpara dhe prapa.

Teknika e ngasjes së automjetit në pjerrtësi gjatësore

Kandidatit i sqarohet si duhet ngasur në pjerrtësi gjatësorë. Gjatë ngasjes në teposhtëze duhet shfrytëzuar frenimin me motor, kjo realizohet duke vendosur në shkallën e transmisionit adekuat (shpejtësinë), sa më e vogël shpejtësia frenim me motor është më e madhë dhe anasjelltas. Nuk duhet fikur motori gjatë ngasjes së automjetit në teposhtëze, te automjetet e reja vjen deri te mos funksionimi i timonit dhe bllokimi i pajisjeve elektronike.

Kandidatit i sqarohet se nuk duhet frenuar vazhdimisht me frenin punues, se mund të vijë deri te nxemja e frenit gjë që mund të vijë deri te dështimi i frenit punues.



Ngasja në teposhtëze

Gjatë ngasjes në përpjetëze kandidatit i sqarohet se duhet ngasur me atë shpejtësi që lejon rrethnat dhe kushtet e rrugës, sa më e vogël shpejtësia e lëvizjes aq më e madhe është fuqia dhe anasjelltas, nxitimi është më i ngadalshëm se sa në rrugë të rrafshët apo në teposhtëze, mund të hasim në ndonjë mjet rrugor që lëviz ngadalë. Rruga e ndaljes është më e shkurtër se sa në rrugë të drejtë dhe në teposhtëze.

Të gjitha këto kushte dhe rrethana duhet të merren parasysh kur ngaset në përpjetëze.



Ngasja në përpjetëze

Kandidati i sqarohet me rastin e nisjes me fre të dorës në përpjetëze si në vijm:


- zgjedhet vendi adekuat për të kryer këtë veprim, mundësisht në pjesën e rrugës kur nuk ka trafik të dendur;
- sinjalizohet me tregues të drejtimit ndaljen e automjetit;
- tërhiqet freni i dorës, dhe ndërruesin e shpejtësisë e vejmë në pozitën lerë;
- automjeti sigurohet nga vetëlëvizja;
- shikohet në pasqyre të brendshme, jashtme, shikimi mbi supe/këndi i vdekur, sinjalizohet me tregues të drejtimit,;
- e vejmë ndërruesin në shkallën e parë transmisionit, lëshohet friksioni deri te “pika e veprimit” në atë moment lëshohet freni i dorës duke koordinuar shtypjen e pedaljes së gasit, dhe vazhdoet lëvizja me automjet.

Ky veprim përsërite deri sa kandidati e përvetson, pasi qe gjatë ngasjes për shkak pengesave në rrugë shpesh ndodh që të ndalem dhe te nisem në përpjetëze.

Kandidatit i sqarohet për automjetin i pajisura me teknologji të avancuar që ka të bëjë me frenin e parkimit dhe mënyra e përdorimit të cilat i përdorë.

Mënyra e parkimit të automjetit në teposhtëze dhe në përpjetëze është paraqitur në figurat vijuese, gjatë parkimit në teposhtëze rrotat kthehen nga skaji i rrugës, ndërruesi i shpejtësisë vihet në pozitë për lëvizje prapa, aktivizohet freni i parkimit.

Ndërsa gjatë parkimit në përpjetëze rrotat kthehen nga mesi i rrugës, ndërruesi i shpejtësisë vihet në shkallën e parë të transmisionit, aktivizohet freni i parkimit.



Parkimi në përpjetëze

Teknika e ngasjes në kolonë



Ngasja në kolon paraqet ngasjen e vështër për kandidatin sidomos në përpjetëze, ku në disa raste duhet ngasur me gjysëmfraksion. Duhet shmangur ndërrimin e shiritit, përveq ku reshtoheni me dal nga kolona ose për parkim.

Kujdes në distancën e sigurisë ndaj mjetit i cili lëvizë para jush, përcjellni veprimet e tij dhe mos frenoni vrullshëm.

Ngasja në kthesa



Ngasja në kthesa

Gjatë ngasjes kandidatit i sqarohet se ngasja në kthesa është e rrezikshme për shkak të ndikimit të forcës cetrifugale, sidomos nëse rruga është e rrëshqitshme ku zvogëlohet kontakti i pneumatikëve dhe rrugës




Shpejtësia e ngasjes në kthesa

Para hyrjes në kthesa përshtatet shpejtësia e lëvizjes. Pasi të kaloj mesi i kthesës gradualisht i pet gas, pasi të kalohet kthesa rritet shpejtësia e lëvizjes nëse lejon kushtet dhe rrethanat në trafik.



Para hyrjes në kthesa përshtatet shpejtësia e lëvizjes, pasi të kalohet mesi i kthesës gradualisht jepet gas, pasi të kalohet kthesa mund të rritet shpejtësia e lëvizjes nëse lejon rrethanat dhe kushtet e rrugës.

Ngasja në kthesë të rrezikshme majtas



Nëse kthesa është djathtas automjeti duhet të zhvendoset në të majtë duke pasur parasysh se mos e shkel vijën e mesit të rrugës, ose anasjelltas nëse kthesa është në të majtë pasi që rrezja e kthesës rritet dhe që mundëson kalimin e sigurt të kthesës.

Ngasja në kthesë

Ngasja gjatë erërave anësore

Kandidatit i sqarohet se ngasja gjatë erërave anësore është e rrezikshme, sidomos për mjetet me dy rrota, mjetet transportuese dhe bashkësive të mjeteve, andaj ku lëvizim në rrugë takohem apo përballkalohem me to duhet me pasë kujdes dhe duhet rritur distancën e sigurt.

Duhet pasur kujdes gjatë tejkalimit të mjeteve transportuese ose bashkësive të mjeteve për shkak të erës anësore të madhe pasi që pas tejkalimit të mjetit mund ta humbni lehtë drejtimin e lëvizjes apo pas daljes nga tuneli apo në pjesët e rrugës ku janë objektet rrugore: viadukti, ura, etj.



Ngasja gjatë erës anësore

Ngasja në diell të fortë

Kandidatit i sqarohet se gjatë ngasjes në diell të fortë mund të mos vërehen situatat e rrezikshme në trafik, përdorimi i mbrojtësve të diellit janë të obliguar.

Duhet të jeni të kujdesshëm gjatë ngasjes, të lëvizni me shpejtësi të përshtatshme varësisht nga intensiteti i dritës së diellit dhe nga kushtet e trafikut.

Ngasja në diell të fortë është e rrezikshme

T11. NGASJA NATËN**Ngasja e automjetit në kushtet të vështira atmosferike dhe natën****Detyrat e instruktorit janë:**

- Jep instruksione për ngasjen e automjetit në kushte atmosferike me shi;
- Jep instruksione për ngasjen e automjetit në rrugë të rrëshqitshme;
- Jep instruksione për ngasjen e automjetit në kushte atmosferike me borë;
- Jep instruksione për ngasjen e automjetit në kushte atmosferike me mjegull;
- Jep instruksione për ngasjen e automjetit për zvogëlimin e dukshmërisë;
- Jep instruksione për ngasjen e automjetit për zvogëlimin e koeficientit të fërkimit.

Ngasja në shi

Kandidati për shofer i sqarohet se ngasja në shi është tej e rrezikshme dhe kërkohet kujdes i shtuar, përveç zvogëlimit të pamjes dhe zvogëlimit të koeficientit të fërkimit të pneumatikëve me sipërfaqen e rrugës, karakterizohet me rrezikun e shpeshtë të defektit të frenit punues i cili laget nga shiu si dhe vështirësohet të drejtuarit të automjetit ku paraqitet fenomeni i ashtuquajtur “*pyka e ujit*” (jastëku i ujit - aquaplaning).



Ngasja në shi



Gjatë shirave të mëdha dhe pas tyre, zakonisht formohen pyka e ujit në rrugë dhe kur automjeti me shpejtësi të madhe has në to, vjen deri te mbulimi i përkohshëm i xhamit mbrojtës duke zvogëluar pamjen nga automjeti. Të njëjtat raste paraqiten edhe me rastin e përballkalimit dhe tejkalimit, kur një sasi uji në rrugën qarkulluese, automjetet e tjera e hedhin në xhamin mbrojtës të automjetit që jeni duke lëvizur ose anasjelltas.

Rruga është veçanërisht e rrëshqitshme gjatë kohës me shi (në fillim kur bie shi), kur në të ka pluhur, yndyrë, baltë, fletë, vaj motori të derdhur, etj.

Meqenëse koeficienti i fërkimi në këso raste është i zvogëluar, rruga e frenimit është më e gjatë, frenat mund të lagen dhe kjo bën që rreziku në trafik të rritet edhe më shumë. Në këto kushte të rrugës së rrëshqitshme duhet të drejtohet me shpejtësi të përshtatshme, frenimi të bëhet me motor (duke kaluar nga shpejtësia më e lartë në më të ulët).

Ngasja në rrugët e mbuluara me borë

Kandidati për shofer i sqarohet se mundësia e lëvizjes së automjetit varet në masë të madhe nga trashësia e borës dhe pesha e bartjes së lëvizshmërisë së automjetit si dhe shkathtësitë e shoferit.

Teknika e të drejtuarit të automjetit nëpër borë mundësisht duhet të jetë kjo: pa ndërrim të shpeshtë të shpejtësive, pa nxitim dhe ngadalësim të vrullshëm, pa kthim të vrullshëm të timonit, etj.



Rruga e mbuluar me borë

Ngasja në rrugët e mbuluara me ngrica

Kandidati për shofer i sqarohet se karakteristikat themelore të ngasjes së automjetit nëpër rrugët me ngrica kanë të bëjnë me zvogëlimin e fërkimit me sipërfaqen e rrugës, rrëshqitjen, vështirësinë e të drejtuarit, rrezikun nga kthimi dhe rrokullisjen e automjeteve, etj



Rruga e mbuluar me ngrica

Ngasja në mjegull

Ngasja në mjegull karakterizohet me dukshmëri të dobësuar (zvogëlim të pamjes) dhe lagështi që



krijohet nga mjegulla në sipërfaqe të rrugës qarkulluese.

Përshtatja e shpejtësisë së lëvizjes

Mund të mos vërehen me kohë këmbësorët dhe mjetet që nuk kanë ndriçim vetanak.

Ngasja në mjegull

Të pamurit është i kushtëzuar nga dendësia e mjegullës, pastaj nga mjegullimi i xhamave në kabinë si dhe nga përdorimi i dritave për ndriçimin e rrugës (të shkurta ose të mjegullës apo mund të jenë të dyja të ndezura në të njëjten kohë) si dhe nga dritat e automjeteve që vijnë përball.

Problemi kryesor i të drejtuarit të automjetit në këto kushte është orientimi i vështirësuar në hapësirë dhe vlerësimi i gabuar i gjerësisë dhe lartësisë, etj.

Shpejtësinë e lëvizjes duhet zvogëluar proporcionalisht me zvogëlimin e të pamurit dhe në funksion të rrugës së ndaljes.

Ngasja natën

Detyrat e instruktorit janë:

- Jep instruksione për përshtatjen e shpejtësisë gjatë ngasjes natën;
- Jep instruksione për përdorimin adekuat të pajisjeve ndriçuese;
- Jep instruksione për drejtimin e shikimit gjatë përballëkalimit;
- Jep instruksione për ti vërejtur këmbësorët si dhe pengesave të tjera të padukshme.

Ngasja natën karakterizohet me dukshmëri të dobësuar zvogëlimi i të pamurit) e që varet nga përdorimi i dritave për ndriçimin e rrugës.

Shpejtësia e lëvizjes varet nga përdorimi i dritave për ndriçim të rrugës dhe në funksion të rrugës së ndaljes.



Dukshmëria e dobësuar

Gjatë ngasjes natën kujdesi duhet të jetë edhe më i madh për shkak se lodhja shfaqet më shpejtë, mund të mos vërehen këmbësorët apo mjetet pa ndriçim vetjak. Veçanërisht duhet pasur kujdes të shtuar kur gjatë ngasjes kalohet nga pjesa e pandriçuar në pjesën e ndriçuar të rrugës ose anasjelltas.

Anashkalimi dhe tejkalim

Detyrat e instruktorit janë:


- Vërteton kushtet për tejkalim të sigurt;
- Jep instruksione për sinjalizimin e veprimit me kohë me tregues të drejtimit;
- Jep instruksione për sigurimin e mbajtjes së distancës anësore të sigurisë;
- Jep instruksione për vlerësimin e nxitimit dhe karakteristikat teknike të automjetit

Ti jep instruksione kandidatit:

- Fazat e veprimeve të anashkalimit dhe tejkalimit;
- Klasifikimi i rreziqeve në rrugët përkatëse;
- Llojet e rreziqeve gjatë ngasjes;
- Perceptimi i shpejtësive të lëvizjes;
- Vlerësimi i distancës së sigurisë (anësore dhe gjatësore);
- Njohuritë për nxitim, ndërrim shiritit;
- Përdorimi i pajisjeve sinjalizuese dhe ndriçuese në mënyrë të rregullt;
- Përdorimi i pajisjeve për dukshmëri nga automjeti;
- Reagimi me kohë për rreziqet që mund të paraqiten në rrugë

Teknika e ngasjes gjatë anashkalimit

Kandidatit duhet sqaruar si kryhet veprimi i anashkalimit në mënyrë të sigurtë. Para se të fillojmë anashkalimin duhet vështruar trafikun nga prapa, pasqyren e brendshme, të jashtme, shikimin mbi supe dhe pasi që të bindemi se mund të kryejmë anashkalimin në mënyrë të sigurtë sinjalizojmë me treguesin e drejtimit.




Anashkalimi

Kandidatit i sqarohet rreziqet e mundshme gjatë anashkalimit si në vijim:

- Mund të nënvlerësohet distanca dhe shpejtësia e automjetit që vjen nga kahu i kundërt,
- Ndonji person mund të dal para ose prapa mjetit të parkuar,
- Mund të hapet dera nga mjeti i parkuar,
- Mos mbajtja e distancës anësore e sigurisë.

Teknika e ngasjes gjatë tejkalimit

Kandidatit i sqarohet se tejkalimi është veprimi më i rrezikshme në trafik, andaj kërkohet kujdes i shtuar gjatë kryerjes së këtij veprimi.



Fazat e tejkalimit

Fazat e tejkalimit

Faza e parë

- sigurohet se tejkalimin nuk e ka të ndaluar sipas rregullave të trafikut dhe sigurisë, dhe sinjalizimit rrugor,
- sipas nevojës, të jap sinjalin akustik;
- të rritet shpejtësia sipas nevojës, duke pasur parasysh mos tejkalimin e shpejtësisë;
- të vështrohet trafiku përpara, anash dhe prapa, të vlerësohet shpejtësia e lëvizjes.

Faza e II

- Të kyç treguesin e drejtimit,
- Të kaloj me automjet në anën e majtë dhe të shikon përpara,
- Të vërteton se automjeti para tij nuk e ka ndermend ta filloj tejkalimin apo të ktheht majtas.

Faza e III

- Pasi te tejkalon automjetin në distancë të mjaftueshëm, jep treguesin e djathtë të drejtimit,
- Në hark të butë kthhet në shiritin që ka lëvizur para tejkalimit,
- Vazhdohet me lëvizjen e automjetit.

Përdorimi i dritave gjatë ngasjes natën

Kandidatit i sqarohet përdorimin i dritave gjatë ngasjes. Si rregull e trafikut gjatë ngasjes përdoren dritat e gjata.



Dritat e gjata gjatë përballkalimit

Kandidati për shoferë në këtë situatë i ndezë dritat e shkurta dhe shikimin e orienton kah skaji i djathtë i rrugës.

Nga dritat e gjata në drita të shkurta kalohet në rastet vijuese:

- Gjatë përballkalimit- në distancë të mjaftueshme, shikohet në tabelën kontrollues , të vërtetohet se cilat dritat janë të ndezur në bazë të llambës kontrolluese.


Në distancë të shkurtë ndaj automjetit që këviz përpara, kandidatit i sqarohet se si të përdor dritat e shkurtëra për ndriqimin e rrugës, duke kontrolluar në tabelën instrumentale.




Dritat e shkurta gjatë ngasjes

Në figurat në vijim janë paraqitur mënyra e përdorimit të dritave gjatë tejkalimit që duhet sqaruar kandidatit.


- Para tejkalimit- përdoren dritat e shkurtat



- Gjatë tejkalimit- vazhdohet edhe me tutje përdorimi i dritave të shkurtëra



- Pas përfundimit të tejkalimit- mund të përdoren dritat e gjata nëse nuk kemi automjetet që vijnë përballë.



Automjeti i cili tejkalohet i ndezë dritat e shkurtëra nëse është afër.

Teknika e ngasjes në kushtet e pavoritshme për ngasje***Teknika e ngasjes në rrugë të rrëshqitshme***

Kandidatit i sqarohen karakteristikat e ngasjes në rrugë të rrëshqitshme dhe masat që duhet të ndërmarr në ato kushte, pastaj se rruga nuk është e rrëshqitshme vetëm dimrit por edhe në periudha të tjera kohore të vitit. Rruga është veçanërisht e rrëshqitshme gjatë kohës me shi (zakonisht kur veç ka filluar të bjerë shi) dhe pastaj kur në rrugë ka baltë, gjethe, vaj motori të derdhur, etj.

Meqë koeficienti i fërkimi në këso raste është i zvogëluar, kandidati duhet të ketë parasysh këto kushte, rruga e frenimit është më e gjatë, frenat mund të lagen edhe më shumë e rrit rrezikun në trafik. Në këto kushte të rrugës së rrëshqitshme duhet të drejtohet me shpejtësi të vogël, frenimi të bëhet mundësisht sa më shumë me motor (duke kaluar nga shkalla më lartë në të ultën) dhe manipulimi me timon bëhet me kujdes dhe jo vrullshëm.



Ngasja në shi

Kandidatit i tregohet se me rastin e përballkalimit apo/dhe tejkalimit, kur një sasi uji gjindet në rrugë, automjetet e tjera e hedhin ujin në xhamin mbrojtës të automjetit, gjegjësisht mundet edhe kandidati i'a hedh ujin të tjerëve në xhamin erëmbrojtës (ballorë).

Teknika e ngasjes në rrugët e mbuluara me borë

Teknika e drejtuarit të automjetit nëpër borë përfshinë: ngasja pa ndërrimin e shpeshtë të shpejtësive, pa nxitim dhe frenim të vrullshëm, kthimit të timonit jo vrullshëm, përshtatja e shpejtësisë (sipas nevojës zvogëlohet) para kthesës, teknika e ngasjes në hyrje, në mesë dhe në dalje të kthesës etj.



Teknika e ngasjës gjatë përballkalimit qëndron në atë që duhet të zvogëlohet shpejtësia e automjetit, pastaj sjellja gjatë tejkalimit, në kolonë duke pasur parasysh rritjen e distancës gjatësore dhe anësore, ngasja në pjertësi gjatësore, përdorimi i frenimit me motor, si reagohe në rast të rrëshqitjes së automjetit në cilin do pjesë të rrugës.

Teknika e ngasjes në rrugët e mbuluara me ngrica



Ngasja në rrugë të rrëshqitshme

Teknika e ngasjes në rrugë me ngrica, kandidatit për shoferë i sqarohet se duhet pasur parasysh se zvogëlohet koeficienti i fërkimit në mesë pneumatikëve me sipërfaqen e rrugës (frenimi dhe nxitimi bëhet në mënyrë graduale), që shumë lehtë mund të vijë deri te rrëshqitja e mjetit apo në kthesa dalja e mjetit nga rruga. Nëse në pjesën e rrugës ku ka ngrica-akull vjen deri te rrëshqitja e mjetit duhet të largohet këmba nga pedalja e gazit dhe shtypet pedalja e friksionit që automjetit të stabilizohet.

Kandidati në pjerrtësi gjatësore -teposhtëze e kalon me automjet këtë pjesë të rrugës, duke përshtatur shpejtësinë e lëvizjes në rast nevojë e zvogëlon shpejtësinë (e largon këmbën nga pedalja e gasit) dhe përdor frenimin e motorit përkatësisht shkallën adekuate të shpejtësisë. Pastaj në rast të rrëshqitjes së automjetit sidemos gjatë ngasjës nëpër kthesa, automjeti të stabilizohet që të mos pengohet dhe rrezikohet siguria rrugore.

Teknika e ngasjes në mjegull



Ngasja në mjegull

Teknika e ngasjes së kandidatit për shoferë nëpër mjegull përfshinë; dritat që përdoren gjatë ngasjes, përshtatja e shpejtësisë varishtë nga dukshmëria e dobësuar (fusha e pamjës së rrugës) në funksion të rrugës së ndaljes, sjellja me rastin e ngadalësimit apo nxitimit si dhe mbajtja e distancës së sigursisë gjatë ngasjes në kolonë, mbajtja e drejtimit në shiritin e trafikut me apo pa sinjalizim horizontal.

Teknika e ngasjes gjatë kohës me diell të fortë

Kandidati gjatë ngasjes me diell të fortë i përdor mbrojtëset e diellit, përshtatja e shpejtësisë varishtë nga intensiteti i dritës së diellit, posaqerisht gjatë ngasjes në kushtet e tilla mund të mos vërehen situatat e rrezikshme dhe reagimi i kandidatit në këto situata duhet të jetë i shpejtë. *Rreziku është në lindje dhe perndim të diellit.*



Ngasja në diell të fortë

Gjendja e sipërfaqes së rrugës

Gjendja e rrugës varet mbi të gjitha nga kushtet e motit, që nënkupton se sipërfaqja e rrugës mund të jetë e thatë dhe e pastër, e ndotur, me rërë, zhavorr, e lagësht, me baltë, mbuluar me gjethe, me borë, e ngrirë - akull, etj. Në rrugë mund të gjendet pluhur, vaj, mbeturina gomash etj.



Kjo gjendje e rrugës zgjatë rrugën e frenimit.

Rruga e mbuluar me gjethe

Gjendja e sipërfaqes së rrugës ndikon në puthitjen e gomave, gjatësinë e rrugës së frenimit dhe mënyrën e drejtimit të mjetit.




Gjatë kohës me shi, borë, akull, rruga bëhet e rrëshqitshme. Në rrugë të ashtuquajtura vrma goditëse paraqesin rrezik në veti edhe te shpejtësitë e vogla, duke u shkaktuar dëme automjeteve në pneumatikë dhe në sistemin e varjes, sidomos gjatë kohës me shi ku ato mbulohen me ujë këto dukuri duhet ti sqarohet kandidatit për shoferë.

Kushtet atmosferike me shi

Jastaku i ujit (ang. Aquaaplannig)- gjatë ngasjes nëpër shi të dendur për shkak sasisë të madhe të ujit krijohet dukuria e ashtuquajtur jastëku i ajrit.

Në këto kushte duhet të zvogëlohet shpejtësia e lëvizjes dhe nuk veprohet vullshëm me timon. Në rast stabilizimit të automjetit shtypet friksioni.



Jastaku i ajrit- shpejtësia e madhe humb kontakti i rrotës me rrugën

Parashkimi dhe perceptimi i situatave në trafik

Gjatë ngasjes shoferi duhet të parashikojë se çfarë mund të ndodhë në trafikun rrugor, ashtu që të jetë i përgatitur për reagim në situata të ndryshme reale që paraqiten në trafik.

Planifikim paraprak para se të ndërmer ndonjë veprim me mjet ka ndikim të madh të sigurisë në trafikun rrugor.

Perceptimi i situatës në trafikun rrugor, reagimi i shpejtë dhe i drejtë në situatat konkrete në trafik, shmangë situatat që rrezikojnë sigurinë në trafik.

Njohuritë dhe përvoja në trafik mundësojnë zbatimin e normave pozitive të mirësjelljes, respektimin e dhe tolerancën ndaj pjesëmarrësve të tjerë në trafik.

Instruktori në të gjitha rastet duhet të jetë i gatshëm të reagoj në rast nevojë dhe të ketë nën kontroll kandidatin për shoferë gjatë aftësimit praktik.

Në vijim janë dhënë disa situata në të cilat janë përshkruar instruksionet e instruktor shoferit.

Instrukcionet për kandidatin për shoferë në këtë situatë janë:

- duhet pasur parasysh se shoferi i veturës mund të dalë papritmas në rrugë;
- duhet vëzhguar sjelljen e tij;
- nëse nuk ka automjeti nga prapa rritet distanca e sigurisë anësore.



Instrukcionet për kandidatin në këtë situatë janë:

- po afrohem qafëmalit;
- jemi afruar në pjesën e rrugës me fushëpamje të kufizuar,
- mund të ndodh që ndonjë automjet ta shfrytëzojë shiritin tonë duke lëvizur;
- përshtatet shpejtësia sipas nevojës zvogëlohet.



Instruktionet për kandidatin në këtë situatë janë:

- largimi i këmbës nga gazi dhe gatishmëria për të frenuar në rast nevojë;
- trocinisti mund të kalojë në shiritin e djathtë të trafikut.



Instruktionet për kandidatin në këtë situatë janë:

- duhet të largohet këmba nga pedalja e gasit dhe të jeni të gatshëm në rast nevojë të frenoni.
- këmbësori mund ta kalojë rrugën paprimtas;
- pas shikimit të trafikut nga prapa, sinjalizohet me tregues drejtimit dhe me kujdes të shtuar kalohet në anë e majtë të rrugës ose rritja e distancës anësore e sigurisë (duke mos e rrezikuar këmbësorin).



Instruktionet për kandidatin në këtë situatë janë:

- duhet ta ndalet vetura;
- të vëzhgohet sjellja e fëmijut me biçikletë;
- të vazhdohet lëvizja vetëm kur bindemi se veprimet e biçiklistit nuk paraqesin rrezik në trafik.




Instrukcionet për kandidatin në këtë situatë janë:

- të frenoni sipas nevojës të ndalet vetura;
- këmbësori vazhdon lëvizjen në rrug, pasi që vetura është parkuar jo drejtë trotuar;
- pasi kalon vetura përball, vështrohet trafiku nga prapa dhe kalohet në anën e majtë të rrugës.



Instrukcionet për kandidatin në këtë situatë janë:

- të frenoni dhe të ndalet vetura;
- këmbësori vazhdon lëvizjen në rrugë pa e shikuar trafikun,
- do të mundësojë këmbësorit kalimin e rrugës edhe pse ai lëviz në mënyrë jo të drejtë (në vendin ku nuk ekziston vendkalimi për këmbësorë)



Instrukcionet për kandidatin në këtë situatë janë:

- do t'ia mundësohet hyrja e veturës në trafik nëse prapa lëviz kolona e automjeteve;
- do të frenoj në rast nevojë.

Kjo situatë ka të bëjë me kulturen në trafik dhe me qendrimi pozitiv në trafikun rrugor.



Instrukcionet për kandidatin në këtë situatë janë:

- të largoj këmbën nga pedalja e gazit (nuk i jap gaz);
- të vëzhgoj lëvizjen e këmbësorit,
- vazhdoj lëvizjen me kujdes të shtuar.



Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë:

- vazhdohet lëvizja me kujdes me shtuar;
- në rritje të distancës anësore të sigurisë,
- në pjesën e rrugës ku zhvillohen punimet në rrugë.




Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë:

- kujdes sepse ndërmjet veturave të parkuar në shiritin e djathtë mund të dalë ndonjë këmbësor apo ndonjë shofer mund të hap derën e automjetit pa shikuar trafikun nga prapa;
- të drejton veturën në mes të shiritit të trafikut;
- kujdes në distancën gjatësore të sigurisë.



Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë:

- duhet të largohet këmba nga pedalja e gasit dhe të jeni të gatshëm në rast nevojë të frenoni.
- pas shikimit të trafikut nga prapa, sinjalizohet me tregues drejtimit dhe me kujdes të shtuar kalohet në anë e majtë të rrugës duke mos e rrezikuar këmbësorin.



Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë:

- të largohet këmba nga pedalja e gazit, sipas nevojës frenohet pasi që mund të ndodh automjeti i bardhë për ndonjë arsye nuk mund të largohet nga rruga;
- nuk lejohet të përdoret buria, ndaj veturë së bardhë e cili ka vepruar në kundërshtim me rregullat e trafikut.



Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë:

- në kujdes të distancës gjatësore të sigurisë;
- veprimet e papritura të kandidatit për shofer që drejton veturën e autoshollës;
- mos përdorim i burisë për t'ia tërhequr vëmendjen atij për të lëvizur më shpejtë.



Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë:

- frenimi,
- biçiklisti është duke lëvizur jo drejt duke kaluar rrugën deri sa shiriti i mjeteve nga kahu i kundërt është zënë me vetura.



Në rast rrezikut të drejtëpërdrejtë duhet të intervenoj instruktori.

Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë:

- duhet jap përparësi kalimi këmbësorëve,
- largohet këmba nga pedalja e gazit,
- sipas nevojës frenohet,
- nuk përjashtohet mundësia se këmbësorët pasi ta kalojnë gjysmën e rrugës kthehen prapa.



Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë:

- duhet jap përparësi kalimi autobusit,
- largohet këmba nga pedalja e gazit,
- sipas nevojës frenohet,
- nuk përjashtohet mundësia se këmbësorët para ose pas autobusit të dalin në rrugë.



Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë:

- afërsinë e vendit ku mund të has fëmijë në rrugë;
- vazhdohet ngasja me kujdes të shtuar;
- sipas nevojës zvogëlohet shpejtësia e lëvizjes,
- duhet të shikohet nga dy anët e vendkalimit për këmbësorë.



Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë:

- Në afërsi të kryqëzimit me rrethrrrotullimit,
- Nuk lejohet lëvizja me shpejtësi më të madhe se 30 km/h;
- në përshtatje të shpejtësisë para kryqëzimit.



Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë:

- nuk lejohet ndërrimi i shiritit të trafikut;
- lejohet lëvizja vetëm drejtë;
- respektohet semafori vazhdohet lëvizja pa u ndalur.



Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë:

- vazhdojna lëvizjen me kujdes të shtuar;
- kemi përparësi kalimi në raport me autobusin;
- mund të dalin udhëtarë para dhe prapa autobusit.



Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë

- lejohet tejkalimi në këtë situatë,
- vështrohet trafiku nga prapa (pasqyre, këndi i
- vedekur)
- duhet sinjalizuar me tregues e drejtimit.



Në këtë situatë jashtë vendbanimit instruksionet për kandidatin janë:

- distanca e sigurisë ndërmjet automjeteve gjatë ngasjes duhet të jetë së paku 2 sekonda;
- rruga e drejtë e gjatë është e rrezikshme;
- mund të tejkalohet nëse nuk kemi automjete që vijnë nga prapa.



Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë

- lejohej tejkalimi i dy mjeteve në të njëjtën kohë;
- vështrohet trafiku nga prapa,
- jepet sinjalizimi me treguesit e drejtimit,
- rekomandohet edhe një herë të shikohet në këndin e vdekut dhe fillohet të tejkalohej veturat.



Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë

- nga vendi i vendosjes së shenjave lejohej lëvizja me shpejtësi më të madhe se 50 km/h;
- pjesën e rrugës ku lejohej tejkalimi;
- kujdes gjatë përballkalimit.



Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë

- në këtë pjesë të rrugës nuk më lejohej të lëvizim me shpejtësi më të vogël se 20 km/h;
- vendi ku kryhen punimet në rrugë fillon nga shenja e trafikut,
- mund të hasim material ndërtimor, makina punës dhe punëtor duke punuar në rrugë.



Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë:

- ndezen dritat e shkurtëra;
- shikimin orientohet nga skaji i djathtë i rrugës;
- zvogëlohet shpejtësia;
- kujdes ndaj veturave të parkuar në anën e djathtë të rrugës.




Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë

- zvogëlohet shpejtësia e lëvizjes;
- zvogëlohet kontakti i rrotave me rrugën;
- nuk manipulohet vrullshëm me timon;
- në rast frenimit zgjatet rruga e frenimit.




Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë

- kufizimi i shpejtësisë deri 40 km/h, fillon nga vendi i vendosjes së shenjës dhe vlenë deri te kryqëzimi i parë;
- në distancë gjatësore të sigurisë.



Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë:

- lejohet vazhdimi i lëvizjes nëse nuk mundeni të ndaleni në mënyrë të sigurtë para kryqëzimit;
- së shpejti ndizet drita e kuqe;
- nuk respektohet shenja “ Rruga me përparësi kalimi”



Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë:

- lejohet kthimi gjysëm rrethor në këtë situatë, duhet përshtatur shpejtësinë;
- duhet sinjalizuar me treguesin e majtë të drejtimit;
- respektojna dritën në semaforë;
- vëzhgojna veprimet e veturës së verdhë.



Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë:

- shenja e trafikut “ Kryqi i Andreut” tregon kalimin e rrugës përtej hekurudhës me një palë binar;
- duhet të ndalemi para shenjës “STOP”;
- pasi të ndalum duhet shikuar në dy anët e hekurudhës(djathtas-majtas);
- pastaj lëvizim me kujdes të shtuar.



Në këtë situatë instruksionet për kandidatin janë:

- të ndalemi para kryqëzimit;
- nëse lirohet rruga dhe kemi hapsirë pas vendkalimit të këmbësorëve (nuk lejohet ndalja në vendkalim nëse bllokohet trafiku)vazhdojna lëvizjen;
- vëzhgojna dritat në semaforë;
- shikojna kushtet dhe rrethanat në kryqëzim.



TË VEPRUARIT SIPAS SHENJAVE TË TRAFIKUT

Instruktori duhet t'i sqaroj të vepruarit sipas shenjave të trafikut konform domethënies së saj.

Gjatë ngasjes keni hasur në këtë shenjë të trafikut instruksionet për kandidatin janë:

- shenja e rrezikut;
- shenja »kryqëzim i rrugës dytësore me rrugën kryesore nën këndin e drejtë nga dy anët»
- tregon afërsinë e kryqëzimit në të cilën rruga me përparësi kalimi kryqëzohet - lidhet me rrugë dytësore;
- mund të hasim në mjetet që vijnë nga rrugët dytësore,
- duhet përshtatur shpejtësin sipas nevojës zvogëlohet.



Gjatë ngasjes keni hasur në këtë shenjë të trafikut instruksionet për kandidatin janë:

- shenja e rrezikut;
- shenja »trafiku zhvillohet dy kahe »;
- tregon vendin ku trafiku zhvillohet dy kahe;;
- mund të hasim në mjetet që vijnë nga rrugët dytësore,
- duhet përshtatur shpejtësin sipas nevojës zvogëlohet.
- kujdes ndaj automjeteve që vijnë nga kahu i kundërt.



Gjatë ngasjes keni hasur në këtë shenjë të trafikut instruksionet për kandidatin janë:

- shenja e rrezikut;
- shenja » paralajmërimi i vendkalimit të shënuar për këmbësor »;
- së shpejti do të arrijm në vendkalim të këmbësorëve;
- mund të hasim në këmbësorë të cilët e kalojnë rrugën në vendkalim,;
- duhet përshtatur shpejtësin sipas nevojës zvogëlohet.



Gjatë ngasjes keni hasur në këtë shenjë të trafikut instruksionet për kandidatin janë:

- shenja e rrezikut;
- shenja »përmbysja – rrëshqitja e mjeteve«;
- tregon afërsinë e vendit në të cilën ekziston rreziku i rrëshqitjes - përmbysjes të mjeteve;;
- duhet përshtatur shpejtësin sipas nevojës zvogëlohet;
- rreziku më i madh kanoset nëse janë kushtet atmosferike të vështira.



Gjatë ngasjes keni hasur në këtë shenjë të trafikut instruksionet për kandidatin janë:

- shenja e urdhrave të prera;
- shenja »ndalja e detyrueshme (obligueshme);
- tregon vendin para hyrjes në kryqëzim, në të cilën shoferi është i detyruar që ta ndal mjetin te vija e te pamurit;
- shenjë e shtohet vija tërthore në rrugë e cila tregon vijën para secilës mjeti duhet të ndalet;
- duhet të zvogëlohet shpejtësia në mënyrë graduale dhe të ndalet automjeti;
- ne jemi duke lëvizur në rrugën dytësore.



Gjatë ngasjes keni hasur në këtë shenjë të trafikut instruksionet për kandidatin janë:

- shenja e urdhrave të prera;
- shenja »përparësi kalimi për mjetet nga kaha e kundërt «.
- mjetet që vijnë nga kahu i kundërt kanë përparësi kalimi;
- ndalem vetëm nëse ka mjete nga kahu i kundërt.



Gjatë ngasjes keni hasur në këtë shenjë të trafikut instruksionet për kandidatin janë:

- shenja e urdhrave të prera;
- ndalohet parkimi.



Gjatë ngasjes keni hasur në këtë shenjë të trafikut instruksionet për kandidatin janë:

- shenja e urdhrave të prera;
- shenja » ndalim trafiku për mjetet tek të cilat tejkalon ngarkesën boshtore të caktuar;
- ngarkesa duhet të shpërndahet sipas ngarkesave nëpër boshte të lejuar;
- nëse respektohet kjo shenjë mbrohet infrastruktura rrugore nga dëmtimet.



Gjatë ngasjes keni hasur në këtë shenjë të trafikut instruksionet për kandidatin janë:

- shenja e urdhrave të prera;
- shenja » shpejtësia më e vogël e lejuar »;
- shpejtësia më e vogël e lejuar përcaktohet me shenjë varësisht sipas kushteve të rrugës dhe nevojave për sigurinë e trafikut;
- nëse rruga është e lirë nuk lejohet të lëvizet nën 40 km/h.



Gjatë ngasjes keni hasur në këtë shenjë të trafikut instruksionet për kandidatin janë:

- shenja e urdhrave të prera;
- shenja » kahe e detyruar djathtas »
- duhet sinjalizuar me tregues të drejtimit;
- duhet pasur kujdes gjatë kthimit djathtas mos po shkelim skajin e ngritur të rrugës.



Gjatë ngasjes keni hasur në këtë shenjë të trafikut instruksionet për kandidatin janë:

- shenja e urdhrave të prera;
- shenja » kahe e detyruar majtas »;
- tregon kahet në të cilat mjeti duhet të lëviz;
- duhet sinjalizuar me tregues të drejtimit;
- duhet pasur kujdes gjatë kthimit majtas duhet ti japim përparësi kalimi mjeteve që vijnë nga kahu i kundërt lëvizin drejtë ose kthehen majtas;
- nëse ka vijen udhëheqës duhet përcjell.



Gjatë ngasjes keni hasur në këtë shenjë të trafikut instruksionet për kandidatin janë:

- shenja e urdhrave të prera;
- shenjat »kahet e lejuar djhtas dhe majtas«
- duhet sinjalizuar me tregues të drejtimit;
- nuk lejohet lëvizja drejtë.



Gjatë ngasjes keni hasur në këtë shenjë të trafikut instruksionet për kandidatin janë:

- është shenjë e lajmërimit;
- shenja » përparësi kalimi në raport me mjetet nga kahu i kundërt «;
- kemi ngushtim rruge;
- duhet përshtatur shpejtësinë e lëvizjes.



Gjatë ngasjes keni hasur në këtë shenjë të trafikut instruksionet për kandidatin janë:

- është shenjë e lajmërimit;
- shenja »mbarimi i kufizimit të shpejtësisë«
- nga vendi i vendosjes së shenjes lejohet shpejtësia më e madhe se sa 40 km/h.



Gjatë ngasjes keni hasur në këtë shenjë të trafikut instruksionet për kandidatin janë:

- është shenjë e lajmërimit;
- shenja »zona e trafikut të qetë «;
- nuk lejohet të lëvizin më shpejtësi më të madhe se 5 km/h;
- lojërat e fëmijëve janë të lejuar në tërë zonën.



Kultura gjatë ngasjes, ngasjes defanzive, dhe eko ngasjes

Kultura trafik

Detyrat e instruktorit janë:

- Jep instruksione për dhënie e përparësisë së kalimit të vet;
- Sugjeron që shoferet t'i tolerojnë gabimet e mundshme dhe mangësitë e pjesëmarrësve tjerë në trafik;
- Mundëson rrjedhën e trafikut nga rrugët dytësore.
- Mundëson kyçjen e mjetit nga vendparkimi.
- Mos insistimi me çdo kusht në përparësinë e kalimit të tij.

Ngasja defanzive

Detyrat e instruktorit janë:

- Jep instruksione për përmirësimin e gabimeve të tjerëve në trafik;
- Jep instruksione për tolerancë ndaj pjesëmarrësve tjerë në trafik;
- Jep udhëzime për planifikimin paraprak të situatave të paraqitura në trafik;
- Jep instruksione për përdorimin e pajisjeve sinjalizuese.

Eko-ngasje

Detyrat e instruktorit janë:

- Zbaton teknikën e eko ngasjes;
- Jep udhëzime për ndërrimin e shpejtësisë;
- Jep udhëzime për përdorimin e gasit;
- Jep udhëzime për shfrytëzimin e fuqisë së motorit.
- Jep udhëzime për shpenzimet minimale të karburantit dhe mbrojtja nga ndotja e ambientit.

T12. NGASJA E PAVARUR- TESTUESE.

Detyrat e instruktorit janë:

a) Jep udhëzime për ngasjen pa instruksione;

- *Jep udhëzime për ngasjen të pavarur;*
- *Zbaton rregullat e trafikut dhe sigurisë;*
- *Zbaton itinerarin e rrugëtimit.*

b) Vlerëson ngasjen pa instruksione:

- *Vlerëson zbatueshmërinë e rregullave të trafikut dhe sigurisë;*
- *Vlerëson teknikën e ngasjes;*
- *Vlerëson ngasjen defanzive dhe eko ngasjen.*

c) Jep mendimin përfundimtar për ngasje

- *Vlerëson rezultatin e arritur gjatë procesit të aftësimit;*
- *Jep mendimin përfundimtar për ngasje;*
- *Propozon orë shtesë kandidatit në rast të mos arritjes së shkathtësive të kërkuara me planprogram*

d) të jep Vendimmarrja e drejtë.

LITERATURA:

1. *Ligji për Rregullat e trafikut rrugor.*
2. *Ligji për Patentë shoferi.*
3. *Akte nënligjore nga ligji për Rregullat e trafikut rrugor dhe patentë shoferi.*
4. *Rregullat e trafikut dhe siguria rrugore me metodikën.*
5. *Naim Mustafa, Metodika e Ngasjes, Gjilan 2005.*
6. *Xhevat Gashi- Patentë Shoferi për kategorinë A dhe B.*
7. *Burime nga interneti.*
8. *Burime tjera.*